

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXVI - Nr. 7781 E shtunë 2 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Dje**  
në "Deutsche Welle"  
Nuk ka të ndalur presioni ndërkombëtar mbi udhëheqësit politikë të Kosovës që ta heqin taksën ndaj produkteve të Serbisë dhe të flasin me ...  
Vijon në faqen 20

Nga BEKIM SHEHU  
Ballkani "vlon", pas Ramës Bolton telefonon Taçin  


**Opinion**  
i Ditës  
Në të gjitha shfaqjet televizive të së enjtes "show" mbizotëroi mbi thelbin. Edi Rama marshoi drejt parlamentit duke mbajtur mbi kurriz jo vetëm peshën ...  
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI  
Kur debati politik merr fytyrën e Gjushit  

Basha, prokurorisë: Duhet të arrestohet  
**"Niçe i bëre gati letrat? Po, kryetar", zbardhet përgjimi i ri Dako-Avdylaj**

Bisedat e reja të kryebashkiakut të Durrësit me të arrestuarin e Shijakut  
Nga KLODIANA LALA  
Vol Vo 4", megaoperacioni i Policisë së Shtetit në kuadër të luftës ndaj krimit të organizuar rezultoi të ishte vetëm maja e ajsgjergut në atë ç'ka do të denoncohej ditët në vijim në media, ndërsa protagonist vijon të mbetet kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako ...  
Në faqen 2

## LISTA/ PROFESIONISTET E SHENDETESISE QE KALUAN FAZEN E PARE TE TESTIT INFERMIERET, EMRAT E 660 APLIKANTEVE FITUES

Kush u kualifikua për një vend pune në portalin "Infermierë për Shqipërinë". Kalendari, datat dhe orari për kandidatët në Tiranë dhe në qarqe



(Në foto) Infermiere (foto ilustruese) Në faqen 10-11

**PROTESTA**  
Pedagogët e Shkencave Sociale në grevë: Rrëzim ligjit të arsimit  
Në faqen 9

**REAGIMI I DASH**  
Refuzim vize për Berishën? SHBA: S'është në listë, por s'komentojmë  
Në faqen 6

**ZGJEDHJET VENDORE**  
Komisionet zgjedhore, PS me 3 dhe 4 anëtarë, LSI "sposton" PR  
Në faqen 5

**"I FORTI" I SHKODRES**  
Burgjet i japin 6 orë liri Safet Bajrit, merr pjesë në varrimin e të atit  
Në faqen 8

**KRYETARI I PD**  
  
Basha prezanton programin ekonomik: Tatim i sheshtë 9%, do anulohet PPP-të  
Në faqen 4

**BLUE TIGHT**  
Erion Zeqiraj: Dashuritë nuk harrohen, por largohen si prioritet  
**E hoqën nga puna me SMS, velina: S'do t'i padis**  
Pse iku Alesa Bami. Rike Roçi bën ëndrrën realitet, merr rol si aktore

Në një rrëfim të bërë disa javë më parë për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", ish-banorja e "Big Brother" 3, Rike Roçi ka thënë se kishte nisur studimet pasi ishte përzgjedhur në një nga akademitë më prestigjioze në Itali lidhur me aktrimin. Ndërkohë që e pyetur më parë



nëse do të niste diku nën rolin e një aktoreje, ajo ka mohuar. Ndërkaq, jo më larg se dje, bukuroshja nga Durrësi ka postuar një video në 'Instastory' ku shfaqeshin dy sekuenca të shkëputura në teatër ku në kuadër shihej Rike. Burime për "Bluetooth" ...  
Suplement

# LIDHJET KRIM-POLITIKE PROKURORIA

Bisedat e kryebashkiakut të Durrësit me Altin Avdylin në dosjen 339/1

Klodiana Lala

**V**ol Vo 4", megaopera cioni i Policisë së Shetit në kuadër të luftës ndaj krimit të organizuar rezultoi të ishte vetëm maja e ajshbergut në atë ç'ka do të denoncohej ditët në vijim në media, ndërsa protagonist vjion të mbetet kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako. Arrestimi i Avdyllëve në Shijak zbuloi atë ç'ka përfliet nën zë prej thujasë një viti nga opozita, por edhe biseda gazetarësh apo studio televizive. "Vol Vo 4" nxori në pah odisenë e dosjes së shumëpërfolur 339, fletë të së cilës tashmë nuk janë më sekret hetimor. Referuar dosjes, mediat raportuan se Avdyllët kishin lidhje me zyrtarë të lartë, një prej të cilëve me pseudonimin 'xhuxhi', ndërsa shumë prej tyre guxuan të thonë edhe se bëhej fjalë për kreun e Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako. Ndërkohë, 25 tetorin e vitit që lamë pas, përmes dokumenteve ekskluzive, emisioin "Të Paeksponuarit" i gazetari Ylli Rakipi në "News 24", publikoi të zezën mbi të bardhë, një përgjim në të cilën kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako komunikonte në telefon me Altin Avdylin, i njohur me pseudonimin Niçja. Në bisedën e përgjuar ku Altin Avdyli identifikohet si Niçja, ndërsa Dako vetëm me numrin e telefonit, kryetari i Bashkisë së Durrësit falenderon Avdylin dhe i kërkoi të takohet. Biseda e parë është zhvilluar më datë 27 qershor në orën 11:08 dhe zgjat 1 minutë e 3 sekonda.

**BISEDA E PARË**

Niçja: Hë kryetar, hë vllai. 0692099300: Niçe, ku je? Niçja: Këtu vërdallë... 0692099300: Ku është Astriti? Niçja: Ka lëviz një çikë. 0692099300: Ku ka lëviz? Jashtë Durrësit? Niçja: Eh... ç'a ka? Ka ndonjë gjë? 0692099300: Po jo mo, doja ta takojsha, ta falenderojsha, ta pyesja një çikë. Niçja: Po, po ku je ti? Të vij të të takoj... Njësoj është, si ai si unë, e di që jemi një 0692099300: Po mirë mo mirë, por doja ta takoj... kanë pi ato. Niçja: Po, e di po, kanë lëviz... Me të taku një çikë unë ty! 0692099300: Unë tani jam duke ardh nga... rrugës... rrugës... **BISEDA E DYTË** Biseda e dytë është bërë nga numri i telefonit 069 56

## Përgjimet me bandën e Shijakut, që "fundosin" Vangjush Dakon

Telefonata: Niçe si je, i bërë gati letrat?



**QENDRIMI I PROKURORISE**  
Prokuroria e Krimeve të Rënda ka konfirmuar vazhdimin e hetimeve për përfshirjen e dyshuar të Avdyllëve në zgjedhje apo në korrupsion. Në tetor 2018, prokuroria deklaroi se po hetonte edhe veprimtarinë e kryebashkiakut të Durrësit, Vangjush Dako.



Kryeministri Edi Rama dhe kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako

**PERGJIMI I RI**

**DAKO:** Niçe si je? I bërë gati letrat?  
**AVDYLAJ:** Po kryetar i bërë.  
**DAKO:** Çoji te vendi se është bërë gati,  
**AVDYLAJ:** Faleminderit kryetar!

merakoset.

**PERGJIMI:**


0698967765: Hë Gjushi!  
0692099300: Hë Niçe  
0698967765: Hë vlla  
0692099300: Hë se jam duke fol me atë, mos e ki merak, ç'ke ti, o nesër... Këto ditë do ta mbaroj unë mos e ki merak?  
0698967765: E të lutem!  
0692099300: Ik pa merak. Pak kohë më pas, më 30 janar të këtij viti, "Zëri i Amerikës" publikoi një tjetër pjesë të "dosjes 339", ku jo vetëm tregohet qartë blerja e votave në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017, por dilte në pah marrëdhënia e ngushtë e Vangjush Dakos me Avdulajt e Shijakut. Dhjetëra përgjime dhe dokumente të siguruar nga BIRN përmes dy hetimeve në Prokurorinë e Krimeve të Rënda hedhin dritë mbi përfshirjen e krimit të organizuar në episode të blerjes së votës në Durrës, Kavajë, Lezhë dhe Dibër, ndërkohë që Shqipëria po shkon drejt një procesi të ri zgjedhor. Komunikimet dhe bisedat për takime me Dakon datojnë në janar të vitit 2017 dhe shtrihen deri në shkurt të vitit 2018. Ato kanë si objekt probleme nga më të ndryshmet si dhe koordinimet për dreka mes tij dhe vëllezërve Avdyli.

Përgjimi 1 (datë 11 shkurt 2017)  
Altin Avdyli: Ne me atë shokun jemi tuj hangër bukë, me Gjushin. Të hanën e patëm lanë të vish me e

taku, megjithatë po e takoj me babën tat, Isakun.

I panjohur: Shife vetë o burrë, nuk ka problem, se vij unë nuk ka problem.  
Altin Avdyli: Jemi me Astritin, të hanën e kemi lënë. Jemi te "Maxhestiku" me Gjushin t'u hangër një drekë. Gazetarja Klodiana Lala ka zbuluar një tjetër përgjim nga dosja 339, pak orë pasi prokuroria tha se ka hapur hetime për rrjedhje informacioni dhe nxjerrje sekreti. Përgjimi tregon një telefonatë mes kryetarit të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako dhe Astrit Avdyli, i akuzuar si koka e grupit kriminal me bazë në Shijak.  
Dako: Niçe si je? I bërë gati letrat?  
Avdyaj: Po kryetar i bërë.  
Dako: Çoji te vendi se është bërë gati.  
Avdyaj: Faleminderit kryetar!

"Unë kam dokumente të tjera, ku Dako flet me Avdylin edhe për biseda që kanë të bëjnë me favore, për shembull në një rast është Dako që e merr në telefon Astrit Avdylin", u shpreh Lala në "Opinion".  
Por ndërsa çështja është në përmasat e një skandali, kryebashkiaku i Durrësit vijon të shfaqet në studiot televizive, herë si 'superman' apo si 'kloun' në emisionin e fundit "Open" të Eni Vasilit, ndërsa tha se kur ha dreka me dikë nuk i interesojnë precedentët penalë... "Balkanweb"



Faksimile e përgjimeve

39 642 (i paidentifikuar) drejt numrit 0898967765 (Altin Avdyli) në orën 20:06 të mbrëmjes me kohëzgjatje 31 sekonda një ditë para zgjedhjeve të 25 qershorit.  
Niçja: Të marr unë se jam me rob pra...  
Alo, ç'a po bën?  
Niçja: Të marr unë se jam me rob të thashë!  
Ku je? Je andej nga fshatrat, ku ishe?  
Jo! Jo! Jo!  
Kam ca me mbiemër Kurti, kam zonjën këtu...  
... po deshe...  
Niçja: ...mirë...  
Niçja: Hajt se të marr unë!  
Thuaj Vangjushit t'i japim ndonjë lek që të votojmë!

**Ç'THA DAKO**

I kontaktuar nga BIRN, Dako refuzoi të komentonte mbi marrëdhëniet e shtrira në kohë me vëllezërit Avdyli, mbi ç'mënyrë ishte ndihmuar prej tyre në zgjedhje apo nëse në këmbim u kishte ofruar atyre zgjedhje të problemeve. "Unë nuk jam marrë asnjëherë në pyetje nga prokuroria", tha ai.  
Dyshimet që lindin nga këto biseda janë se Vangjush Dako e ka përdorur për qëllime elektorale të PS-së, bandën e trafikut të kokainës në Shijak, duke vërtetuar tezën e opozitës se Rilindja i ka toleruar bandat duke kërkuar si këmbim ndihmën e tyre në zgjedhje. Vetëm një javë më pas "Të paeksponuarit" publikuan



**ULTIMATUMI**

"Edi Rama largohu deri në datën 15 shkurt, sepse në datën 16 populli do të të shkulë nga karrigia. Prokuroria shqiptare arresto Vangjush Dakon, pasi në të kundërt në datën 16 prangat do t'ia vënë qytetarët. Koha për fjalët ka mbaruar vëllezër e motra, prandaj merrni fatin e vendit në duart tuaja"- tha z.Basha.

**Vasili: Hetimi për 'Zërin e Amerikës', faqe e zezë e prokurorisë**

Për kryetarin e grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, hetimi i prokurorisë për 'Zërin e Amerikës', e cila ka nisur me urdhër të kryeministrit Rama, është faqe e zezë e prokurorisë. Pak ditë më parë 'Zëri i Amerikës' dhe BIRN publikuan përgjime të reja, që janë pjesë e dosjes 339/1, ku po hetohet për krim elektoral në disa qytete të vendit, ndërsa përmendet edhe kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako. Sipas materialit të publikuar, përgjimet tregojnë se dy vëllezërit Astrit dhe Altin Avdyli kanë drekuar të paktën dy herë me Dakon në fillim të vitit 2017. "Prokuroria hap hetim për 'Zërin e Amerikës' me urdhër të zvarranikut të karrigës Edi Rama? Faqe e zezë e prokurorisë se kapur nga zvarraniku i pushtetit Edi Rama. S'ka të krahasuar as me Partinë e Punës. Kjo prokurori e turpit mbylli veprat penale të Edi Ramës që i kërkoi policisë të bënte fushatë elektorale për Partinë Socialiste, që mashtroi popullin dhe tha se kishte bërë ekspertizën e audio-përgjimit të vëllait të ish-ministrit të brendshëm, që i mbylli çështjen pasi Edi Rama kërcënoi oficerin Emiljano Nuhu se tregoi fakte të vërteta kundër qeverisë. Kjo prokurori guxon dhe hap hetim për 'Zërin e Amerikës'. Dhe ndaj kujt? Ndaj 'Zërit të Amerikës'. Ky është tamam fundi. Kjo ishte reforma në drejtësi, ky ishte vetingu, kjo është 'drejtësia e re'. Prokurori e vënë në shërbim të një zvarraniku pushteti si Edi Rama, këtij më të shplarit e më të pëshitrit e zvarranikëve të karrigës me merimanga të pushtetit", shprehet z.Vasili.



**Shoqëria "Rojen 03" shpk**

ka importuar Cigaren me te re nga Spanja **Desert Blue** and **Desert Red** me çmim 250 LEK"

Kreu i PD, akuza të forta Dakos: Hajdut votash, shëmbëlltyra e regjimit që sundon vendin

**Basha, thirrje prokurorisë: Arresto Dakon para 15 shkurtit**

*"Në të kundërt, prangat do t'ia vënë qytetarët"*

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha gjatë takimeve dje me qytetarët e Durrësit, i ftoi ata që të marrin pjesë në protestën e 16 shkurtit për të rrëzuar qeverinë "Rama". Gjatë fjalës së tij para Bashkisë së qytetit të Durrësit, z.Basha i bëri thirrje kryeministrit Edi Rama të largohet para 15 shkurtit, pasi në datën 16 shkurt qytetarët do ta shkulnin nga karrigia e pushtetit. Gjithashtu kryedemokrati i bëri thirrje prokurorisë të arrestojë kreun e Bashkisë së Durrësit brenda datën 15 shkurt pasi ndryshe do ia vendosin prangat qytetarët. "Të bashkohemi të gjithë në protestën e 16 shkurtit. Por e shoh që ju jeni bashkuar pa ardhur ende data për interesin e vendit dhe të qytetit të Durrësit. Institucionet e vendit nuk ju shërbejnë më juve, por vetëm një grusht oligarkëve, pasi kjo qeveri nuk ka ardhur nga votat tuaja. Koha e fjalëve ka mbaruar. Durrësi mezi po pret. Nga kjo ndërtesë që pritët të çlirohet shumë shpejt jap mesazhin: Edi Rama largohu deri në datën 15 shkurt, sepse në datën 16 populli do të të shkulë nga karrigia. Prokuroria shqiptare arresto Vangjush Dakon, pasi në të kundërt në datën 16 prangat do t'ia vënë qytetarët. Koha për fjalët ka mbaruar vëllezër e motra prandaj merrni fatin e vendit në duart tuaja"- tha Basha. Nga qyteti i Durrësit kreu i opozitës akuzoi se Vangjush Dako është shëmbëlltyra e regjimit që sundon sot Shqipërinë. Lideri i demokratëve u shpreh me tone të ashpra ndaj kreut të Bashkisë së Durrësit, ndërsa e quajti atë si "simbolin e betonimit", që ka uzurpuar çdo gjë jashtë parametrave urbane. "Vangjush Dako është shëmbëlltyra regjimit që sundon sot Shqipërinë. Axhenda normale e interesit publik është axhenda e punësimit, gjallërimit të ekonomisë dhe luftës kundër varfërisë. Ne si PD, jemi të vendosur t'i japim vendit mundësinë e rimëkëmbjes së shpresës dhe besimit të kapacitetet e vendit. Këtë e shohim te çmontimi i rreziqeve kryesore të kapjes nga krimi, shkatërrimi rrjetit oligarko-kriminal që ka kapur

vendimarrjen në nivel qendror dhe lokal. Këtu në Durrës është shembulli se si në nivel lokal ka degjeneruar në formën e shëmbëlltyrës e Vangjush Dakos, i cili është edhe kryebashkiaku i votave të vjedhura, edhe autori i vjedhjes së votave të 2017-ës, përfituesi kryesor i betonizimit të Durrësit, njeriu që ka shkelur çdo rregull, çdo parametër urban, për çdo leje ndërtimi

që ka dhënë në këtë qytet, dhe njeriu që përcakton që betonierët mund të kalojnë vetëm nëse janë të kompanisë së tij dhe vetëm njerëzit që janë lidhur me të mund të punojnë dhe të ecin përpara. Është shëmbëlltyra e regjimit që sundon sot Shqipërinë"-u shpreh kreu i PD-së. Prej kohësh Partia Demokratike akuzon kryebashkiakun e Durrësit, Vangjush Dako, se është i lidhur me bandën e Avdyllajve. Akuzat e PD, lidhen me disa përgjime që kanë dalë në media, ku Dako komunikon me njërin nga anëtarët e bandës së Avdyllajve, Altin Avdyllaj. Sipas PD-së, Dako bashkëpunoi me Avdyllajt për të blerë votat në Durrës ndaj i kërkon prokurorisë prangosjen e kryebashkiakut të Durrësit.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Durrës

**Deputeti i PD: 7 të dënuar dhe disa në kërkim**

**Salianji publikon videon: Dako duke festuar me "grupet kriminale"**

Deputeti demokrat, Ervin Salianji publikoi dje një video ku shihet Kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako në një tryezë festive, bashkë me persona të tjerë. Në Facebook, Salianji shprehet se në këtë tryezë po festohet fitorja e zgjedhjeve, ndërsa të pranishëm janë persona që janë të dënuar dhe disa të tjerë në kërkim. "Hareja e kimit! Triumfi i së keqes! Fitorja e zgjedhjeve festohet bashkë me bandat, në tetor në seancën e Kuvendit denoncova me emra dhe me video se si festohej vjedhja e zgjedhjeve. Vetëm në këtë tavolinë, 7 persona të dënuar dhe disa në kërkim. Sot të provuar dhe në përgjime zyrtare të prokurorisë!", shprehet z.Salianji. Edhe më herët në parlament, në muajin tetor, Salianji denoncoi me emra persona e pranishëm në festën ku është i pranishëm Vangush Dako. Sipas tij, kryebashkiaku i Durrësit festoi fitoren e zgjedhjeve në shoqëri të Durim Keçit, person i njohur për lidhjet me bandat kriminale. "Sot nuk del dhe ta falënderojë për gjithë kontributin që ka dhënë", tha Salianji. Ai sh-



**AKUZA**

"Fitorja e zgjedhjeve festohet bashkë me bandat, në tetor në seancën e Kuvendit denoncova me emra dhe me video se si festohej vjedhja e zgjedhjeve. Vetëm në këtë tavolinë, 7 persona të dënuar dhe disa në kërkim. Sot të provuar dhe në përgjime zyrtare të prokurorisë!", tha z.Salianji.

toi se në këto pamje, vetëm në një tavolinë janë shtatë persona të kërkuar nga policia dhe dy prej tyre shumë shpejt do të jenë pas hekurave. "Gjushi i Durrësit dhe Çela i Durrësit bashkë me të arrestuarin e këtyre kohërave shikohet duke festuar me muzikë dhe me hare fitoren e zgjedhjeve. Ja urdhëroni se e keni të plotë se si gëzojnë fitoren e zgjedhjeve pushteti

kriminal", - është shprehur z.Salianji. Ndërkohë dy ditë më parë Vangush Dako deklaroi se ulet dhe ha darkë me këto që mbështet Partinë Socialiste në zgjedhje, ndërkohë që shtoi se ai ia di për faleminderit çdo përkrahësi. Ai tha se nuk i pyet personat nëse kanë precedent penal dhe se ai është në shërbim të të gjitha shtresave të shoqërisë.

# PROGRAMI OPOZITA

Kreu i PD: Ekonomia do të çlirohet nga zaptimi i tregut, nga krimi dhe oligarkia


## Paralajmërimi i Bashës: Kur të vijmë në pushtet, do anulohen PPP "Shqipërinë e bëjmë ndër 30 vendet reformatore"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, para shoqatave të biznesit dhe sipërmarrësit prezantoi dhe shtyllat kryesore të programit politik të PD-së. Demokratët parashikojnë ulje të ndjeshme të taksave si frymëmarrje ndaj biznesit dhe Lulzim Basha premtoi ulje të TVSH-së dhe ulje të çmimit të naftës, ndërsa tha se rikthehet taksa e sheshit në vlerën 9%. Opozita shënjestron si problemet kryesore të vendit sot futjen e parave të kimit në ekonomi dhe favorizimin e pak bizneseve që janë pranë kryeministrit duke dëmtuar garën e ndershme dhe lufta ndaj këtij fenomeni do të jetë prioritet për demokratet. "Për biznesin e vogël, brenda 100 ditëve të para, do të realizohet rritja e kufirit të regjistrimit për TVSH nga 2 milionë lekë xhiro vjetore në 14 milionë lekë ose 140 mijë dollarë. Ujlen e kontributit të sigurimeve shoqërore nga rreth 24% në 18% për të vetpunësuarit, ndërsa për të punësuarit 9%. Ujlen e çmimit të energjisë, taksë 9% dhe rimbursim rekord i TVSH-së. Taksa "Rama" për karburantet, prej rreth 30 lekë/litër do të shfuqizohet menjëherë. Kjo nisim do të ndjehet si nga biznesi i madh, ashtu edhe ai i vogël. Tatimi sheshit në nivelin 9% për: tatimin mbi fitimin, tatimin mbi të ardhurat nga paga mbi 30 mijë lekë, tatimin mbi të ardhurat e tjera personale dhe kontributin e punëdhënësve dhe punëmarrësve për sigurimet shoqërore. Metodologjia e çmimit të energjisë elektrike për biznesin (por edhe për popullatën) do të reformohet rrethësisht. Çmimi i energjisë për biznesin do të jetë 30-40% më i lirë sesa sot", deklaroi z.Basha. Gjatë takimit me biznesin, Basha paralajmëroi sistemin bankar që të mos financojë projektet abuzive të Partneritetit Publik Privat duke ripërsëritur qëndrimin se asnjë kontratë, leje apo licencë, e fituar në mënyrë abuzive nuk do të mbetet në fuqi. "Kemi sinjale që 1.5 miliardë dollarë kontrata korruptive do të hidhen në treg këtë vit. E paralajmëroj sistemin bankar dhe institucionet financiare të mos bëhet pjesë e kësaj piramide, nëse nuk duan që kjo piramidë t'i marrë me vete", theksoi z.Basha. Programi ekonomik i PD synon që kontratat dhe lejet abuzive të shfuqizohen, në 100 ditët e para të qeverisjes të eliminohen burokracitë për biznesin, të shkatërrohet rrjeti shtetëror i gjobëvënies ndaj biznesit dhe brenda mandatit të parë Shqipëria të rënditet në listën e 30 vendeve më refo-



**QEVERISJA**  
Programi ekonomik i PD synon që kontratat dhe lejet abuzive të shfuqizohen në 100 ditët e para të qeverisjes, të eliminohen burokracitë për biznesin, të shkatërrohet rrjeti shtetëror i gjobëvënies ndaj biznesit dhe brenda mandatit të parë Shqipëria të rënditet në listën e 30 vendeve më reformatore.



Tryeza e djeshme e PD-së, për prezantinim e programit ekonomik

### PROGRAMI EKONOMIK I PD: LUFTË OLIGARKËVE, RRIJTJE PAGASH, ULJE TË ÇMIMIT TË ENERGJISË DHE NAFTËS

- Dëmi më i madh për vendin në këto 6 vitet është vrasja e shpeshës. Me alternativën tonë synojmë të ndalim këtë epidemi dhe t'u japim shqiptarëve mesazhin se vendi ynë ka shpresë.
- Programi ekonomik i PD vendos në punë sipërmarrjen shqiptare, afron investitorët e huaj, duke çliruar nga burokracia dhe korupsioni gjeneratorin e punësimit dhe mirëqenies.
- Qëllimi final është ta bëjmë Shqipërinë tërheqëse për investimet e huaja direkte. Thithja e tyre në funksion të rritjes së punësimit është objektivi më i rëndësishëm prioritar i kësaj platforme.
- Shtylla e parë kryesore e planit të PD është çlirimi i ekonomisë nga trinitomi krim-oligarki-burokraci. Kriza në ekonomi është edhe produkt i bashkëpunimit të qeverisë me krimin, interesat e të cilit janë vënë mbi ato të qytetarëve.
- Transaksionet e blerjes së votave për llogaritë të pushtetit janë shndërruar në transaksione ekonomike, duke shkatërruar tregun, duke shtyrë jashtë tregut gjithë sipërmarrjen e ndershme.
- Oligarkia meriton të rrijë luftë si krimi, sepse po rënon biznesin e vogël e të mesëm, që nuk është në tepsinë e pushtetit. Do të luftohet me të njëjtat instrumente si krimi i organizuar, me konfiskimin e pasurive të oligarkëve.
- U bëj thirrje bizneseve, pjesë e projektit korruptiv të 1.5 miliardë euro koncesione e PPP, si dhe sistemit bankar të ndalin menjëherë këtë marrëzi. Asnjë prej kontratave korruptive të lidhura me Edi Ramën nuk do të zbatohen. -Nëse do të jemi para zgjedhjes për të financuar këto kontrata apo pagat, pensionet,

- shkollat e spitalet, zgjedhja jonë është e qartë dhe e vendosur: do të falimentojmë oligarkët dhe jo Shqipërinë.
- Çdo kontratë koncesionare, PPP-je e lidhur me këto oligarkë, gjithsecila prej tyre do të shfuqizohet. Ky nuk është kërcënim, ky nuk është premtim. Ky është vendim dhe ne do ta bëjmë realitet.
- Derregullimi do të prekë çdo pjesë të administratës shtetërore në qeverinë e PD. Çdo leje, licencë apo autorizim, i cili nuk justifikon veten, do të shfuqizohet brenda 100 ditëve të para të qeverisjes tonë.
- Inspektoratet e çdo lloji, që janë kthyer në banda grabitqarësh do të riorganizohen me anë të një reforme prioritare brenda 100 ditëve të para të qeverisë së PD.
- Me thjeshtimin e sistemit tatimor, uljen e taksave në 9%, uljen me 300 lekë/litër të çmimit të karburanteve, uljen e çmimit të energjisë dhe lehtësi të tjera të parashikuara në program, njerëzit do të kenë më shumë para në xhepa dhe do të hapen më shumë vende pune.
- Programi i PD jep mbështetje konkrete për fermerët dhe prodhimin vendës. 100 milionë USD subvencionim direkt, 50 milionë USD investime. Natë pa akcizë për fermerët dhe peshkimin, Mbrojtje e prodhimit vendas, akces në treg.
- Arsimi në planin e PD është prioritet kombëtar. Dyfishim i buxhetit për arsimin e lartë, 10 mijë stazhe të paguara në vit për studentët. Modeli gjerman për arsimin profesional me fokus tek IT, Agropërpunimi & Turizmi.
- Shqiptarët i kanë të gjitha mundësitë të rikthejnë besimin tek ekonomia dhe tek njëri-tjetri. PD është e vendosur të zbatojë plotësisht këtë plan për zhvillimin e ekonomisë me mundësi për të gjithë.

mature. Por biznesi i kërkoi prova besimi dhe e ftoi Lulzim Bashën që hapin e parë për këtë bashkëpunim ta nisë që tani në opozitë, duke përdorur të gjithë instrumentet parlamentarë. Në programin ekonomik, Partia Demokratike ka parash-

ikuar reformim të thellë të sistemit të licencave dhe inspektorateve, 150 milionë dollarë subvencione për fermerët dhe dyfishim të buxhetit për arsimin e lartë. Kryedemokrati Basha bëri të qartë se programi ekonomik parashikon një paketë speci-

fike për thithjen e bizneseve të huaja. "Oligarkia do të ketë të njëjtën luftë si krimi me të njëjtat instrumente, siç luftohet krimi i organizuar. Programi ekonomik i Partisë Demokratike është hartuar me ekspertizë të CDU-së gjermane".

### Kryekëshilltari i CDU: Rama dështoi, qytetarët të mbështesin Bashën

Kryekëshilltari ekonomik i grupit të CDU, Dr.Martin Henze Henze, i pranishëm dje në tryezën e prezantimit të programit ekonomik të PD-së theksoi se qeveria "Rama" ka dështuar. "Politika ekonomike në Shqipëri që nga viti 2013 ka dështuar. Shifrat e papunësisë janë shumë të larta. Para dy ditës bisedova me zotin Ervin Bushati të PS, i cili më foli për shifra që nuk m'u dukën të besueshme, sepse vetëm nga viti 2015, nga vendi i uaj kanë ikur çdo vit mbi 58 mijë njerëz", - tha ai. Sipas tij, "reforma e propozuar nga Lulzim Basha është e domosdoshme të realizohet. Së pari, për të plotësuar kushtet për një reformë politike për perspektivën e anëtarësimin në BE, së dyti për të krijuar një stabilitet dhe siguri për të gjithë sipërmarrësit dhe qytetarët".

### Programi i PD-së, Tabaku: Ekonomi konkurruese, liri bizneseve

Deputetja demokrate, Jorida Tabaku numëroi dje probet ekonomike të programit të qeverisë. Gjatë prezantimit të programit ekonomik të PD-së, tabaku përmendi se vendi numëron një barrë fiskale shtesë prej 1.9 mld eurosh ku 97% e bizneseve dhe konsumatorëve e mbajnë këtë barrë. Tabaku theksoi se programi i PD i jep biznesit atë që kjo qeveri ka më shumë frikë, që është liria. Sipas Tabakut, janë ngushtuar mundësitë e sipërmarrjes dhe inovacionit dhe se qeveria godet biznesin në kurriz, ndërkohë që përkëdhel një grup të vogël bizneseve. "Kemi vënë re se sistemi fiskal është konvertuar në armën me të cilën qeveria godet biznesin në kurriz, ndërkohë që përkëdhel një grup të vogël bizneseve duke krijuar monopole në treg. Ekonomia jonë sot vuan kreditimin e ulët, vuan mungesën e besimit, vuan rënien e prodhimit. Punësimi në vend ka rënë. Sipërmarrjet e vogla janë duke u mbyllur, 60 të tilla në ditë, një rekord i zi për regjistrat dhe regjistrimit të bizneseve shqiptare. Vendi sot fatkeqësisht ndodhet në zgripin e errësirës, një vend më pak i ndërlidhur me rajonin, një vend më pak i ndërlidhur mes vetes, një vend që sot ka infrastrukturën më të dobët, pabarazinë më të lartë, kostot më të larta të koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private", u shpreh Tabaku. Ajo tha më tej se detyrimet e prapambetura kanë shkuar në 200 milionë euro e borxhi po arrin në 83%. "Ne ju ofrojmë atë që kjo qeveri ka më shumë frikë, lirinë. Lirinë tuaj për sipërmarrje, për subvencionim, për biznesin tuaj dhe vizionin tuaj inovator. Besoj ka ardhur koha që të mos shtyhem më të largohemi nga ky vend. Ka ardhur koha që ta kthejmë ekonominë e tregut në një ekonomi konkurruese duke pasur ju në bazë", theksoi Tabaku.



## Cakaj zhvillon vizitën e parë si ministër, pritët nga Mogherini

Gati dy javë pasi mori edhe de facto detyrën e ministrit të Jashtëm, Gent Cakaj ka zhvilluar dhe vizitën e parë zyrtare në cilësinë e kreut të diplomacisë shqiptare. Dhe vizita e parë ka qenë e një rëndësie të veçantë, sidomos për vendet kandidatë për t'u anëtarësuar në BE. Gent Cakaj, mori pjesë në takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendeve kandidatë, i cili u zhvillua në Bukuresht më 31 janar - 1 shkurt, në kuadër të presidencës rumune të Këshillit të Ministrave të BE-së. Ai eci në tapetin e kuq ceremonial, para se të pritej në hyrje të pallatit ku u zhvillua takimi nga ministri i Jashtëm i Rumanisë, Teodor Melescanu dhe shefja e diplomacisë së BE-së, Fe-



Ministri i Jashtëm, Gent Cakaj dhe shefja e diplomacisë së BE-së, Federica Mogherini

### INTEGRIMI

Ministri Cakaj vlerësoi mbështetjen e vendeve anëtare të BE-së në rrugën e integritimit evropian të Shqipërisë, vuri në dukje përpjekjet dhe arritjet e deritanishme në këtë proces, duke shprehur angazhimin e vendosur për forcimin e tyre, si edhe pritshmëritë tona që bisedimet e anëtarësimit të jenë njohje e arritjeve dhe mekanizëm për orientimin e tyre të ardhshëm.

derica Mogherini. Diskutimet gjatë këtij takimi u përqendruan në çështjet kryesore të axhendës evropiane dhe ndërkombëtare, sfidat e përbashkëta dhe bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme dhe të

sigurisë. Ministri në detyrë Cakaj, pasi vlerësoi mbështetjen e vendeve anëtare të BE-së në rrugën e integritimit evropian të Shqipërisë, vuri në dukje përpjekjet dhe arritjet e deritanishme në këtë proces, duke shprehur angazhimin e vendosur për forcimin e tyre, si edhe pritshmëritë tona që bisedimet e anëtarësimit të jenë njohje e arritjeve dhe mekanizëm për orientimin e tyre të ardhshëm.

derica Mogherini. Diskutimet gjatë këtij takimi u përqendruan në çështjet kryesore të axhendës evropiane dhe ndërkombëtare, sfidat e përbashkëta dhe bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Ministri në detyrë Cakaj, pasi vlerësoi mbështetjen e vendeve anëtare të BE-së në rrugën e integritimit evropian të Shqipërisë, vuri në dukje përpjekjet dhe arritjet e deritanishme në këtë proces, duke shprehur angazhimin e vendosur për forcimin e tyre, si edhe pritshmëritë tona që bisedimet e anëtarësimit të jenë njohje e arritjeve dhe mekanizëm për orientimin e tyre të ardhshëm. Ai evidenti, gjithashtu, rolin proaktiv e konstruktiv të Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajon, duke shtuar se në aspektin global, vendi ynë dëshmon me vendosmëri orientimin e tij strategjik euroatlantik dhe linjëzime të plotë me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Socialistët kanë marrë edhe anëtarin që sipas Kodit i takon partisë së dytë

# Komisionet zgjedhore, PS me 3 dhe 4 anëtarë, LSI sponston PR-në

## Ndarja e komisionerëve sipas gjendjes faktike të partive

Komisionet zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta do të administrohen nga vetëm tre forca politike, PS, PD dhe LSI. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi dhe vendimin për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), që do të ngrihen dhe funksionojnë për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019. Sipas këtij vendimi tre anëtarë do propozohen nga Partia Socialiste, dy anëtarë propozohen nga Partia Demokratike dhe një anëtar do propozohet nga Lëvizja Socialiste për Integritim. Një ndarje kjo që vjen si rrjedhojë e konfigurimit politik të Kuvendit të Shqipërisë. Kodi Zgjedhor përcakton që 2 anëtarë propozohen nga partia më e madhe e mazhorancës, 2 nga partia më e madhe e opozitës, 1 anëtar nga partia e dytë më e madhe e mazhorancës dhe 1 nga partia e dytë më e madhe e opozitës. Ndërkohë që për të përcaktuar forcat që janë në mazhorancë dhe ato në opozitë KQZ i ka dërguar një letër Kuvendit ku i ka kërkuar informacion mbi gjendjen faktike të pozicionit të partive parlamentare. Por ky përcaktim ligjor është i vështirë për tu zbatuar në rastin konkret. Kjo pasi pjesë e mazhorancës është vetëm Partia Socialiste dhe për rrjedhojë ajo fiton të drejtën, për shkak të balancimit politik të komisioneve, të propozojë



dhe anëtarin që sipas kodit duhet ta propozonte partia e dytë më e madhe e mazhorancës. Për rrjedhojë PS në këto komisione do ketë 3 anëtarë. Nga ana tjetër opozita do ketë një përfaqësues me 2 anëtarë të PD-së dhe 1

anëtar të LSI-së. Në këtë mënyrë LSI me kalimin në opozitë në 2017, i ka marrë të drejtën për të pasur komisioner Partisë Republikane. Po ashtu të drejtën për të pasur komisioner në këto zgjedhje e ka humbur edhe

### SHORTI

Goglat përcaktuan se Partia Socialiste do ketë anëtarin e shtatë dhe kryetarin në KZAZ-të me numër çift, ndërsa Partia Demokratike do ketë anëtarin e shtatë dhe kryetarin në KZAZ-të me numër tek. E njëjta mënyrë konfigurimi do jetë edhe për komisionet e qendrave të votimit KQV.

PDIU, e cila prej disa muajsh është pozicionuar në opozitë me qeverinë. Gjithashtu, gjatë mbledhjes së djeshme KQZ hodhi dhe shortin për anëtarin e shtatë të KZAZ-ve. Goglat përcaktuan se Partia Socialiste do ketë anëtarin e

shtatë dhe kryetarin në KZAZ-të me numër çift, ndërsa Partia Demokratike do ketë anëtarin e shtatë dhe kryetarin në KZAZ-të me numër tek. E njëjta mënyrë konfigurimi do jetë edhe për komisionet e qendrave të votimit KQV. Ndërkohë që KQZ vazhdon të funksionojë pa dy përfaqësuesit e opozitës. Por përveç dy vakanceve të krijuar në KQZ nga mungesa e propozimit të anëtarëve të rinj nga opozita, në mbledhjen e kësaj të premtë asnjë nga 2 forcat kryesore të opozitës nuk kishin sjellë përfaqësuesit e tyre ligjor në këtë institucion. Nga ana tjetër, nëse partitë parlamentare do të bien dakord të miratojnë ndryshimet në Kodin Zgjedhor, KQZ duhet të rinisë nga e para procesin përgatitor për zgjedhjen e bazuar në rregullat e reja, disa prej të cilave parashikojnë dhe depolitizimin e KZAZ-ve.



Meta takon Bregun:

### Mbështetje projekteve

që nxisin pajtimin rajonal

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dhe një takim të veçantë Majlinda Bregun, por jo si një politikane shqiptare, por në cilësinë e Sekretares së Përgjithshme të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal. Njëpër një postimi në rrjetet sociale presidenti e shprehur kënaqësinë e tij për takimin e zhvilluar me Majlinda Bregun ndërsa shprehur bindjen në suksesin e saj në detyrën e re. Meta nuk kurseu edhe mbështetjen për të dhe për projektet që nxisin ndërlidhjen dhe pajtimin rajonal. "Kënaqësi e veçantë të takohesha me Sekretaren e Përgjithshme të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, Majlinda Bregu. Suksesi i punës së saj do të jetë suksesi i #RC dhe i bashkëpunimit rajonal. Mbështetje të plotë projekteve që nxisin ndërlidhjen dhe pajtimin rajonal", - shkroi Meta.

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 25.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shiten e pasurisë së paluajtshme, Arë me sip. 1,500 m<sup>2</sup> me nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi me vlerë fillestare në ankand 378,000 (Treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 27.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shiten e pasurisë së paluajtshme, Trulli me sipërfaqe totale 112 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr pasurisë 161/36, Vol.6, Fq.122, ZK.8516 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIKA BËTON" Sh.P.K., me adresë Durres, me vlerë fillestare në ankand 7,338.6 (Shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë pike gjashtë) EURO. Dhe Pasuri e paluajtshme. Trulli me sipërfaqe totale 1260 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr pasurisë 162/35, Vol.7, Fq.236, ZK.8516 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIKA BËTON" Sh.P.K., me adresë Durres, me vlerë fillestare në ankand 82,355 (Etdhjetë e dhjetë e pesëqind e pesëqindë e pesë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 01.03.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-rë për shiten e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/229 , ZK. 8250, me sipërfaqe 137 m2 me adresë Tiranë, në pronësi Z.Bujar Musa Kajtazi me vlerë fillestare në ankand 98.880 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.

Departamenti i Shtetit i përgjigjet "GSH"-së për dyshimet e ngritura nga Rama

# A iu ndalua Sali Berishës hyrja në SHBA? Ja si përgjigjet DASH

*"Nuk diskutojmë rastet individuale të vizave"*

Sali, ti e kapërcen dot oqeanin me dash? Hajde përgjigju, ti me dash e kapërcen dot oqeanin Sali?". Kjo pyetje retorike e Edi Ramës dje në Kuvend la të kuptohej se ish-kryeministri Sali Berisha mund t'i jetë ndaluar shkelja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dyshimet u shtuan pasi vetë Berisha nuk e mohoi këtë menjëherë, por dha një përgjigje evazive duke thënë, "nuk bëj vizita zyrtare që kur lashë detyrën". Por, menjëherë pasi doli nga seanca në komunikim me gazetaret dhe më pas në mbledhje, në një lidhje telefonike me "Opinionin" e Fevziut, Berisha mbajti qëndrim më të qartë. "Që nga dita kur kam lënë detyrën time, nuk kam bërë asnjë kërkesë për të shkuar në asnjë vend të globit. Nuk më është refuzuar asnjë vizë", tha ai. Pavarësisht mohimit të Berishës, misterit mbetete duke qenë se lajmi u dha publikisht nga dikush, të cilit informacioni nuk i mungon, kryeministri i vendit. Për të mësuar të vërtetën, "Gazeta Shqiptare" iu drejtua ambasades amerikane në Tiranë duke marrë përgjigjen standarde: "Nuk diskutojmë raste specifike vizash". Pas kësaj, "GSH" i dërgoi një kërkesë për informacion Departamentit të Shtetit. Në përgjigjen drejtuar kryeredaktorit Erl Murati, zyra e Çështjeve Publike në DASH u përgjigj: "Rastet e refuzimit të vizës që lidhen me çështje të korrupsionit, të cilat Departamenti i Shtetit



Ambasada e SHBA-ve në Tiranë

ka zgjedhur t'i publikojë, ndodhen këtu: <https://www.state.gov/j/inl/rls/prsl/2018/index.htm>. Siç mund ta shihni, Sali Berisha nuk është në këtë listë. Përtej këtyre pak publikimeve, (në listë ndodhen Adriatik Llalla, Tom Doshi dhe familjet përkatëse) në përgjithësi Shtetet

e Bashkuara nuk komentojnë çështje individuale të vizave", shkruhet në përgjigjen e Scott Lueders, specialist i çështjeve publike në Byronë e çështjeve ligjore dhe trafikut të narkotikeve në DASH. Pra, siç shihet edhe nga ky sqarim, emri i Berishës nuk është pjesë e listës


**RAMA MBRON THAÇIN**  
"Furnizoi me naftë tanket e kasapit të Beogradit. Bëri thirrje për të refuzuar Rambujenë. Shpalli terroristë marksistë-leninistë luftëtarë e UÇK-së. Ibrahim Rugova s'denjojti fliste më derisa vdiq. Sot e quan Presidentin e Kosovës argat albanofob të Beogradit! Vesi del me shpirtin", - shkroi Rama dje në "Twitter".

së personave që u është refuzuar hyrja në SHBA për çështje që kanë të bëjnë me korrupsionin. Ndryshe nga sa ndodhi në rastin e ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla, për të cilin vendimin për refuzim të vizës e mori vetë ish-Sekretari i Shtetit, Rex Tillerson. Jo vetëm kaq,



por për këtë rast DASH doli edhe me një njoftim zyrtar të publikuar në faqen zyrtare ku bënte të ditur se Sekretari i Shtetit, Rex Tillerson e kishte miratuar masën e ndalimit për shkak të përfshirjes së ish-zyrtarit shqiptar në raste të mëdha korrupsioni. Në njoftimin e bërë publik në faqen zyrtare të Departamentit Amerikan të Shtetit, thuhet se, "ligjet amerikane parashikojnë që në rastet kur ka informacione të besueshme se zyrtarë të huaj përfshihen në raste madhore korrupsioni, ose në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, këtyre individëve dhe familjes së tyre të afërt u ndalohet hyrja në Shtetet e Bashkuara". Përveç Llallës, sekretari Tillerson miratoi ndalimin e hyrjes në Amerikë edhe të bashkëshortes së tij, Ardjana Llalla dhe dy fëmijëve të tij.

**Heqja e vizës?  
Burime nga qeveria:  
Berisha ka dëmtuar  
interesat e SHBA**

Pavarësisht reagimit të Departamentit Amerikan të Shtetit, mazhoranca është e bindur se ish-kryeministri Sali Berisha i është refuzuar hyrja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Burime nga qeveria kanë këmbëngulur edhe dje në vërtetësinë e asaj që deklaroi kryeministri Rama lidhur me këtë çështje. Sipas tyre, përgjigja e DASH përjashton mundësinë që atij t'i jetë refuzuar viza për çështje të korrupsionit, siç është rasti i Llallës, por jo që atij t'i jetë refuzuar hyrja në SHBA për çështje të tjera. Madje, të tjera burime bëjnë me dije se heqja e vizës ndaj Berishës lidhet me qëndrimet e tij ndaj SHBA dhe sidomos ndaj çështjes së Kosovës. "Heqja e vizës për Berishën është më e pakta. Berisha ka dëmtuar interesat e SHBA...", - tha një burim nga qeveria, që nuk pranoi t'i përmendje emri. Sipas tyre, ky refuzim nga ana e SHBA-ve lidhet pikërisht me qëndrimet e vazhdueshme që ish-kryeministri Berisha ka mbajtur ndaj marrëveshjes Kosovë-Serbi.



This project is funded by the European Union

Albanian National Training and Technical Assistance Resource Center

## 2<sup>ND</sup> ROUND CALL FOR PROPOSALS

Terre des hommes Albania (TdH) in partnership with the Albanian National Training and Technical Assistance Resource Centre (ANTTARC) are jointly implementing the project: **"Strengthening Civil Society to Prevent and Protect Children from Abuse and Violence in Albania"**, financed by the European Union.

The overall objective of this EU project funded under the European Instrument for Democracy and Human Rights is:

- Strengthen child rights civil society organizations (CSOs) capacities and their role in child protection and family strengthening through structured capacity building programmes and technical assistance.
- Empower child rights CSOs to be drivers of change through development and advocacy of child protection and family strengthening models and good practices through a sub-grants scheme, networking, establishing a network of CSO trainers, monitoring and advocacy.

In this framework the 2<sup>nd</sup> Round of Call for Proposal under the Sub-Granting Scheme is publicized and effective **January 7<sup>th</sup>, 2019** until **February 7<sup>th</sup>, 2019**.

The overall amount made available under this Call for Proposals is **98,000 EUR**. TdH Albania aims to award around **7 (seven)** projects, which must fall between the following minimum and maximum amounts:

- Medium size sub-grants (10,000 -14,000 EUR) ( up to 7);

The deadline for the submission of applications is **February 7<sup>th</sup>, 2019 at 17:00 hrs**.

The application package and related information must be found to the following links: [www.childhub.org](http://www.childhub.org); [www.tdh.ch](http://www.tdh.ch); [www.eeas.europa.eu/delegations/albania](http://www.eeas.europa.eu/delegations/albania); [www.anttarc.org](http://www.anttarc.org); Terre des hommes Albania and Terre des hommes Europe Facebook profiles.



**Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

## TENDER NOTIFICATION

### SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for supply with fuel for airside vehicles, fuel station, for a period of two year with possibility of renewal.

The company needs to have the respective license for fuel supply, and also be equipped with it's own tanker, that will deliver the fuel to Tirana International Airport fuel station.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com); [fvojka@tirana-airport.com](mailto:fvojka@tirana-airport.com); [ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com) specifying, request for information for "Supply with Fuel for Airside Vehicles Fuel Station".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION FOR TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT'.

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
Procurement Department  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs** on **7 February 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all the following addresses: [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com); [fvojka@tirana-airport.com](mailto:fvojka@tirana-airport.com); [ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com)

## Bie me 20 miliardë lekë kredia për ekonominë, FMN: Shkak, edhe largimi i bankave europiane

Largimi nga Shqipëria i disa bankave me origjinë nga vendet e Bashkimit Europian duket se ka filluar të japë efektet e para negative në ekonomi. Fondi Monetar Ndërkombëtar deklaroi se tërheqja e grupeve bankare të BE-së ka dëmtuar kreditimin e ekonomisë shqiptare, duke kufizuar ofertën. Të dhënat e fundit zyrtare nga Banka e Shqipërisë tregojnë se kredia për ekonominë vitin e kaluar ra me 20 miliardë lekë, ose 160 milionë euro, duke konfirmuar se Shqipëria po përballet me një ngjerr të thellë kreditimi. Sipas statistikave, në nëntor të vitit të kaluar, kredia totale që bankat kanë dhënë për individët dhe bizneset zbriti në 534 miliardë lekë, nga 554 miliardë që ishte në nëntor të 2017-ës. Të dhënat

### STATISTIKAT

Të dhënat e fundit zyrtare nga Banka e Shqipërisë tregojnë se kredia për ekonominë vitin e kaluar ra me 20 miliardë lekë, ose 160 milionë euro, duke konfirmuar se Shqipëria po përballet me një ngjerr të thellë kreditimi. Sipas statistikave, në nëntor të vitit të kaluar, kredia totale që bankat kanë dhënë për individët dhe bizneset zbriti në 534 miliardë lekë, nga 554 miliardë që ishte në nëntor të 2017-ës.

të vitit të kaluar, kredia totale që bankat kanë dhënë për individët dhe bizneset zbriti në 534 miliardë lekë, nga 554 miliardë që ishte në nëntor të 2017-ës. Të dhënat

e detajuara tregojnë se thuasë e gjithë rënia ka ardhur nga kredia për biznesin, gjë që penalizoi investimet e reja në ekonomi. Bankat me origjinë nga vendet e BE-së

kanë qenë kreditorët kryesorë të ekonomisë. Por, pas krizës së vitit 2008, disa prej tyre janë larguar, ose kanë ulur ekspozimin në ekonomitë e Ballkanit, përfshirë Shqipërinë, duke lënë pas një boshllëk jo të vogël në ofertën e kredive. Sipas FMN-së, veç tërheqjes së bankave europiane, arsye të tjera se përse Shqipëria po përballet me ngjerr të kreditimit janë niveli i lartë i informalitetit, por edhe zbatimi i dobët i ligjit. Në deklaratën zyrtare, bordi i drejtorëve ekzekutiv të FMN-së u ka rekomandu-



ar qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë të ndërhyjnë me masa të shpejta për të rigjallëruar kreditimin e ekonomisë, duke listuar uljen e kredive të këqija, forcimin e së drejtës së pronës dhe zba-

timin e ligjit të falimentit. Sipas FMN-së, këto masa janë të domosdoshme, pasi ngjerrci i kredive është risku i dytë më i madh që mund të dëmtojë rritjen ekonomike, pas ngadalësimit të Eurozonës.

Kosto e rrugës Durrës-Kukës vlerësohet të ketë kaluar në 1 miliard euro

# "Taksa e rrugës Durrës-Kukës", buxheti mbledh 700 milionë euro

Financat: Arkëtimet nga viti 2010, deri në vitin 2018



### TAKSA


Që nga viti 2010 kur janë publikuar të dhënat e detajuara mbi të ardhurat, arkëtimet nën emërtimin nga taksa rrugës Durrës-Kukës janë rritur vit pas viti. Të dhënat reflektojnë grumbullimet nga viti 2010-2017, por sipas të dhënave nga Tatimet, arkëtimet nga ky zë janë mbi 15 miliardë lekë edhe me 2018.

për këtë taksë, ajo u ndërtua me fonde të tjera nga buxheti i shtetit dhe kreditë e huaja sindikatë, duke filluar nga viti 2007.

**KOSTOJA**  
Kosto e rrugës Durrës-Kukës vlerësohet të ketë kaluar në 1 miliard euro, sipas raportimeve në Kuvend të Ministrisë së Infrastruktura të vitin e kaluar. Ato ende nuk kanë përfunduar vijojnë dhe vijojnë të finanohen ende nga buxheti i shtetit në aksin Kukës-Morinë, ky një urë nuk përfunduar ende. Kosto e rrugës Durrës-Kukës llogaritet sa 10 për qind e Pro-

dhimit të Brendshëm Bruto. Kostoja e lartë e rrugës përveç rritjes së barrës fiskale, çoi në rritjen e borxhit me rreth 3% të PBB-së. Në vitin 2019, ministri i Financave të asaj kohe nënkroi një kredi sindikale me vlerë 250 milionë euro, e cila u mor me terma tregtar dhe pa konkurrencë nga "Deutsche Bank" kundrejt një interesi 11% me afat shlyerje tri vite. Për këtë arsye, borxhi publik në vitin 2009 theu kufirin 60% të vendosur në buxhet, duke arritur nivelin më të lartë në rajon, nga rreth 53% që ishte më 2008. Por pagesat nuk kanë

mbaruar akoma. Qeveria shqiptare vitin e kaluar ka aktivizuar një kontratë koncesionare, e cila do të mirëmbajë Rrugën e Kombit për 30 vitet në vijim kundrejt pagesave 5-22,5 euro, sipas llojit të automjeteve. Koncesioni u aktivizua në shtator 2018. Si rrjedhojë, qytetarët shqiptarë do të paguajnë së paku edhe 400 milionë euro pagesa direkte për rrugën e Kombit në 30 vitet e ardhshme ndaj kompanisë koncesionare "Albania". Sipas parashikimeve nga kontrata, të ardhurat e kompanisë pritet të jenë rreth 400 milionë euro gjatë 30 viteve nga të cilat rreth 338 do të financohen nga taksat dhe 65 milionë euro në 13 vitet e para si subvencion për trafikun e munguar. Teksa ka filluar dhënia e rrugëve me pagesë, ekspertët rekomandojnë heqjen e taksës së qarkullimit, e cila paguhet nga konsumatorët të çmimi i naftës.



### Shkeljet e shoqërive publike

KLSH: 10 miliardë lekë dëm nga kompanitë shtetërore dhe investimet e huaja

Rreth 10 miliardë lekë është dëmi ekonomik i konstatuar për vitin 2018 nga shoqëritë në pronësi të shtetit dhe investimet me fonde të huaja. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka publikuar një raport sipas të cilit mësohet se nga rezultatet e auditimeve të kryera në këto dy sektorë për vitin 2018, zbardhin dëmin prej 10 miliardë lekësh. Në të paraqiten rezultatet e kontrolleve të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja për vitin 2018. Auditimet e kryera gjatë vitit 2018 janë kryesisht auditime përputhshmërie, ligjshmërie dhe rregullshmërie, si dhe auditime financiare. Masa për shpërbim dëmit ekonomik, eliminimin shpenzimit jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, te ardhura të munguara janë në shumën gjithsej 10,2 miliardë lekë, nga të cilat shuma 6,7 miliardë i përket dëmit ekonomik dhe 3,5 miliardë për efektin negativ financiar ose shpenzime jo në përputhje me ligjet. Sipas fushave të auditimit përkatëse konstatohet dëmi ekonomik: në shoqëritë publike në vlerën 6,7 miliardë lekë dhe në projektet me financime të huaja në vlerën 62 milionë lekë. Në raport theksohet se KLSH i është drejtuar prokurorisë me 4 kallëzime penale, për 5 drejtues apo administratorë të shoqërive dhe 4 indicie për kallëzim penal.



### RAPORTI

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka publikuar një raport sipas të cilit mësohet se nga rezultatet e auditimeve të kryera në këto dy sektorë për vitin 2018, zbardhin dëmin prej 10 miliardë lekësh.

Buxheti i shtetit ka arkëtuar nga viti 2010 deri në fund të vitit 2018 mbi 700 milionë euro nga taksa e rrugës Durrës-Kukës. Shifrat bëhen të ditura nga Ministria e Financave në kuadër të një projekti të përbashkët me Bankën Botërore për transparencën e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore "Spending and performance, data and results". Portali për të dhënat e hapura jep të dhëna të detajuara me zërat e shpenzimeve dhe të ardhurave, ndër to është edhe një zë të ardhurash, "taksa e Rrugës Durrës-Kukës", ose taksa e qarkullimit, e cila vit pas viti ka sjellë miliarda lekë në buxhetin e shtetit, ku vetëm për 2010-2018 numërohen 90.1 miliardë lekë. Sipas "Monitor", që nga viti 2010 kur janë publikuar të dhënat e detajuara mbi të ardhurat, arkëtimet nën emërtimin nga taksa rrugës Durrës-Kukës janë rritur vit pas viti. Të dhënat reflektojnë grumbullimet nga viti 2010-2017, por sipas të dhënave nga Tatimet, arkëtimet nga ky zë janë mbi 15 miliardë lekë edhe me 2018.

### TAKSA

Në dhjetor të vitit 2001, qeveria e ish-kryeministrit të asaj kohe, Ilir Meta, në presionin e FMN shfuqizoi taksën e solidaritetit të vënë nga paraardhësi Pandeli Majko në vitin 2000, që ishte 700 lekë mbi makinat dhe 100 lekë mbi pagat mujore me qëllim ndërtimin e autostradës së rrugës Durrës-Kukës. Taksa e cila u vol për më shumë se dy vjet rreth u shfuqizua pasi ligjet kombëtare dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar nuk lejonin krijimin e një fondi paralel me buxhetin e shtetit për më shumë se një vit fiskal dhe u transferua të qarkullimi i automjeteve. Taksa e qarkullimit u rrit vit pas viti, e cila aktualisht është 27 lekë për litër, pa TVSH. Ndonëse taksapaguesit paguan për vite me radhë

Zbulohet dokumenti për lejen e dhënë për "kapon" e grupit kriminal

Klodiana Lala

TIRANË

I konsideruar si kreu i një grupi tejet të rrezikshëm kriminal, që ka vepruar ndër vite në Shkodër e që mund të jetë një ndër subjektet që do t'i nënshtrohet ligjit famëkeq "41 biss", ose ndryshe burgut të egër, Safet Bajri doli ditën e djeshme 6 orë në liri, për t'i dhënë lamtumirën e fundit babait të tij. Lajmi konfirmohet nga burime zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat sqaruan se leja e veçantë për të paraburgosurin Bajri u dha vetëm pasi u mor edhe miratimi i Prokurorisë për Krime të Rënda dhe asaj të Shkodrës. Në shkresat e prokurorive, që disponon "Gazeta Shqiptare" është miratuar leja që Safet Bajri të marrë pjesë në varrimin e të atit, por duke e konsideruar si person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, institucionet e akuzës kërkuan nga burgjet që në bashkëpunim me Policinë e Shtetit të marrin masa për të siguruar mbarëvajtjen e zbatimit të lejes. I konsideruar si i "forti" i Shkodrës, Safet Bajri u nis drejt qytetit të lindjes rreth 10:20 të paradites së të premtës për të mbërritur në varrimin e të atit rreth orës 13.00. Burime të besuara për "Gazeta Shqiptare" thanë se jo vetëm policia kishte marrë masa sigurie, por edhe vetë familjarët janë kujdesur për këtë. I paraburgosuri mësohet se ka shkuar fillimisht në banesën e tij e më pas drejt varrezave, për t'u kthyer pas 6 orësh dhe izoluar sërish në ambientet e paraburgimit 313 në Tiranë.

# I vdes babai, Drejtoria e Burgjeve i jep 6 orë liri të "fortit" të Shkodrës, Safet Bajri

## Ceremonia e varrimit, blutë "blindojnë" qytetin verior



Safet Bajri




Faksimile e lejes për Safet Bajrin

### MASAT E SIGURISË

I konsideruar si i "forti" i Shkodrës, Safet Bajri u nis drejt qytetit të lindjes rreth orës 10:20 të paradites së të premtës për të mbërritur në varrimin e të atit rreth orës 13.00. Burime të besuara për "Gazeta Shqiptare" thanë se jo vetëm policia kishte marrë masa sigurie, por edhe vetë familjarët janë kujdesur për këtë. I paraburgosuri mësohet se ka shkuar fillimisht në banesën e tij e më pas drejt varrezave, për t'u kthyer pas 6 orësh dhe izoluar sërish në ambientet e paraburgimit 313 në Tiranë.

### ARRESTIMI NË TIRANË

Safet Bajri u vu në pranga në shtator të 2018-ës në zonën e "Xhamllikut" në kryeqytet, në kuadër të megaoperacionit të koduar "Oaz". Ai ka qenë në një bilardo dhe sapo kanë hyrë forcat RENE, ka hedhur armën e zjarrit pistoletë, e cila është konstatuar nga efektivat e policisë. Bajri dyshohet të jetë kreu i një grupi kriminal që kryente trafik droge, vrasje dhe trafikim ndeshjesh. Rezultoni se Bajri është dënuar edhe nga drejtësia belge për akuzën e shfrytëzimit të prostitucionit, dënim të cilin po e vuan në Shqipëri.



**Kultivimi i drogës, kapet 55-vjeçari i dënuar me 4 vite burg**

**LEZHË** - Një 55-vjeçar nga Mirdita është arrestuar dhe nga policia e Lezhës, pasi ishte në shpallur në kërkim. Në pranga ka përfunduar Kol Rregji, ndaj të cilit Gjykata e Lezhës ka dhënë masën e dënimit me 4 vite burg për "Kultivim të bimëve narkotike". "Pas një pune hetimore të mirorganiuar kapëm shtetasin e shpallur në kërkim Kol Rregji. Ky shtetas është dënuar me 4 vite burg nga Gjykata e Shkallës Parë Lezhë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendim të datës 11 Prill 2018, për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike". Ngjarje e ndodhur në gusht të vitit 2015, ku në parcelën pronë të tij, janë konstatuar të kultivuara bimë narkotike kanabis sativa", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë.

### DOKUMENTI

"Gazeta Shqiptare" ka siguruar dokumentin që i siguroi lejen për të dalë nga burgu një prej personave më të rrezikshëm në Belgjikë dhe i konsideruar si koka e një grupi po kaq të rrezikshëm, që e kishte shtrirë aktivitetin e tij kriminal edhe në qytetin e Shkodrës. Ka qenë IEPV "Jordan Misja" apo burgu 313, ai që ka miratuar lejen e veçantë për të paraburgosurin Safet Bajri dhe ia ka dërguar Prokurorisë së Shko-

drës. Në këtë dokument sqarohet se për rastin e Bajrit janë paraqitur dokumente që vërtetojnë fatkeqësinë që i ka ndodhur në familje. Konkretisht, atij i ka vdekur babai, shtetasi Jonuz Rustemi Bajri, i cili është varrosur dhe në orën 12:00 në një ceremoni në qytetin e Shkodrës, ku mori pjesë edhe i biri, Safet Bajri.

Ndër të tjera, dokumenti thekson se, për shkak të rrezikshmërisë së personit që po i miratohet leja kërkohet marrja e masave të larta të sigurisë në bashkëpunim edhe me Policinë e Shtetit, çka lë të kup-

tohet se për gjashtë orët që Bajri ka qëndruar në liri, Shkodra është blinduar sërish. Leja për lirin e Safet Bajrit mban datën e 31 janarit 2019.

### KUSH ËSHTË SAFET BAJRI

Safet Bajri u arrestua pasditen e 21 shtatorit të vitit që shkoë në zonën e "Xhamllikut" në kryeqytet, në kuadër të megaoperacionit "Oaz". Ai ka qenë në një bilardo në zonën e "Xhamllikut" dhe sapo kanë hyrë forcat RENE, ka hedhur armën e zjarrit pistoletë, e cila është konstatuar nga efektivat e policisë. Po ashtu, në një opera-

cion të zhvilluar në qytetin e Shkodrës, Policia e Shtetit vuri në pranga edhe 4 persona, të njohur dhe të afërm të Safet Bajrit, e më konkretisht: Ilir Rustemi (Bajri), 42 vjeç; Emrah Plaku, 22 vjeç; Astmer Bilali, 29 vjeç dhe Erogen Brajoviq, 36 vjeç. Këta persona, sipas policisë, janë anëtarë të grupeve kriminale aktive në qytetin e Shkodrës, por edhe më gjerë. Grupi kriminal "Bajri" nga Dobraci i Shkodrës akuzohet për vrasje me dashje, gjobëvënien, trafik droge dhe pastrim parash. Anëtarë të këtij grupi kriminal akuzohen edhe si autorë

të disa prej ngjarjeve kriminale që kanë tronditur kryeqendrën e veriut. Më 25 janar të vitit 2017, Safet Bajri u dënua nga Gjykata e Apelit e Brukselimit me 9 vite burg si kreu i një organizate kriminale të trafikimit të drogës dhe prostitucionit në kryeqytetin belg. Kjo organizatë është përgjegjëse gjithashtu për shkatërrim të pronës, përdorim të armëve të zjarrit, tentativë vrasje, zhvatje e trafik të qenieve njerëzore me qëllim prostitucionin. Gjithashtu, mbi Bajrin rëndon edhe një dënim tjetër i 22 shkurtit 2014 nga Gjykata e Brukselimit.

## Grabitja dhe dhunimi i kambistit në Memaliaj, arrestohet në Tiranë organizatori Donaldo Nelaj

**TIRANË** - Policia e Gjirokastrës në bashkëpunim me atë të Tiranës kanë identifikuar brenda një kohe të shkurtër autorët e grabitjes së dhunshme në Memaliaj, ngjarje kjo e ndodhur mbrëmjen e 22 janarit të këtij viti. Ditën e djeshme është arrestuar në kryeqytet organizatori i kësaj grabitjeje. Bëhet fjalë për 22-vjeçarin Donaldo Nelaj, i cili më herët ishte shpallur në kërkim nga policia e Gjirokastrës. Mësohet se i riu rezultoi të jetë person me precedentë kriminalë, pasi është akuzuar më parë për vjedhje me dhunë dhe transport të lëndëve narkotike. Pak ditë më parë blutë e stacionit të policisë



Memaliaj arrestuan edhe 18-vjeçarin Dali Nelaj, Ari Isomati 19 vjeç dhe Armando Cakaj 19 vjeç, të tre banues në Memaliaj si bashkëpunëtorë në këtë ngjarje. Gjithashtu, bashkëpunëtor në këtë

ngjarje ka rezultuar edhe 24-vjeçari Ervis Hysi nga Gjirokastra, që aktualisht kryen dënimin në burgun 313 Tiranë pas arrestimit për veprat penale: "Kanosje" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje



### Eskorta e Ramës u përfshi në aksident, Garda: Faji i trajlerit

**TIRANË** - Kryeministri Edi Rama ka qenë duke udhëtuar dhe drejt Beratit, kur një prej makinave të eskortës është përfshirë në aksident. Pak pas ngjarjes, burime nga Garda sqaruan rrethanat e ngjarjes. Sipas Gardës, një trajler i ka prerë rrugën mjetit të eskortës, i cili është dëmtuar lehtë. Ndërsa nga përplasia nuk ka persona të lënduar. Sipas ekspertizës, e cituar nga Garda, faji për aksidentin ishte i trajlerit. Aksidenti ndodhi pranë Gosës në Kavajë. I pari që foli për ngjarjen ishte ish-kryeministri Sali Berisha, i cili publikoi mesazhin e qytetarit dixhital dhe fotot nga aksidenti.



Vendimi/ Të hënën mbledhet asambleja e fakulteteve të Universitetit të Tiranës

# Pedagogët e Shkencave Sociale, grevë pa afat deri në rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë

## "Të bashkohen të gjitha universitetet publike në vend"

Voltiza Duro

Në një kohë që studentët e Filologjikut, Shkencave Sociale dhe një pjesë e Juridikut vazhdojnë bojkotin e mësimit, pedagogët kanë zhvilluar dje një takim me ministrin e Arsimit, Besa Shahini. Pas këtij takimi, që sipas pedagogëve të UT-së ishte joproduktiv, u mbledh asambleja e Fakultetit të Shkencave Sociale në të cilën u vendos grevë e përgjithshme nga ana e pedagogëve. "Pedagogët e Fakultetit të Shkencave Sociale, të mbledhur në asamblenë e dytë, kanë vendosur t'i shkojnë deri në fund solidarizimit me studentët dhe realizimit të kërkesave të tyre. Sot (dje) vendosën të hidhen në grevë, duke u bërë thirrje kolegëve të të gjitha universiteteve publike që t'u bashkohen.

Pavarësisht problemeve të larmishme, Fakulteti i Shkencave Sociale mbetet hapësira më e dinjitetshme e jetës universitare shqiptare.

Studentët dhe pedagogët e bashkuar kanë për të futur! "-theksojnë pedagogët.

**NJOFTIMI NGA FSHS**

Një javë më parë, pedagogët kishin lënë datën 1 shkurt si afat të fundit për plotësimin e kërkesave të tyre dhe rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë. Duke qenë



Mark Marku duke folur për mediat

**THIRRJA**

"Pedagogët e Fakultetit të Shkencave Sociale, të mbledhur në asamblenë e dytë, kanë vendosur t'i shkojnë deri në fund solidarizimit me studentët dhe realizimit të kërkesave të tyre. Sot (dje) vendosën të hidhen në grevë, duke u bërë thirrje kolegëve të të gjitha universiteteve publike që t'u bashkohen", - theksojnë pedagogët.

se ministria përgjegjëse dhe qeveria nuk ndërmori asnjë masë për zgjidhjen e situatës, pedagogët hynë në grevë urie pa afat. "Ditën e sotme (djeshtë) ka pasur një sërë zhvillimesh në lidhje me kauzën universi-

tare. Në orën 09:00 pati një takim tonin me znj. Besa Shahini, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ndërsa në orën 11.00 është zhvilluar mbledhja e Senatit të Universitetit të Tiranës. Më vonë znj. Shahini doli në



Pedagogët e Fakultetit të Shkencave Sociale, në asamblenë e dytë

konferencë për shtyp. Dhe në orën 14.00 u mbledh Asambleja e Personelit Akademik të Fakultetit të Shkencave Sociale. Në takimin me ministrin, grupi i pedagogëve paraqiti argumente të thelluara për kërkesat e paraqitura nga Takimi i asambleve të fakulteteve të UT. Ndryshe nga sa pritej, si hap logjik i kërkesave të paraqitura prej takimit të asambleve të fakulteteve të Universitetit të Tiranës datës 25 janar 2019, znj. Shahini nuk këtheu asnjë përgjigje konkrete për realizimin e këtyre kërkesave. Qëndrimi i saj ishte që

brenda "Paktit për Universitetin" marrin zgjidhje të gjitha problematikat e arsimit të lartë", -theksohet në vendimin e pedagogëve të Shkencave Sociale. Ndërkohë në deklaratën për mediat, Senati i Universitetit të Tiranës, iu bëri thirrje studentëve të ngujuar brenda godinës së Juridikut që të lirojnë ambientet sa më shpejt në mënyrë që pjesa e studentëve që dëshirojnë mësim t'i rikthehet në audiotore. "Asambleja e FSHS, me kuorum dhe shumicë votash, vendosi për shpalljen e grevës pa afat. Në këto kusht-

**MBLEDHJA**

"Grupi i autorizuar nga Takimi i Asambleve të fakulteteve të Universitetit të Tiranës, reagon si më poshtë: Thërret takimin e asambleve të fakulteteve të Universitetit të Tiranës ditën e Hënë, datë 4 shkurt 2018, ora 11.00, Godina Liria, në koherencë me vendimin e marrë në takimin e datës 25 janar 2019, për t'u rimbledhur pas përgjigjes nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë", - nënvizohet në njoftimin e pedagogëve të Shkencave Sociale.

te, grupi i autorizuar nga Takimi i Asambleve të fakulteteve të Universitetit të Tiranës, reagon si më poshtë: Thërret Takimin e Asambleve të fakulteteve të Universitetit të Tiranës ditën e Hënë, datë 4 shkurt 2018, ora 11.00, Godina Liria, në koherencë me vendimin e marrë në takimin e datës 25 janar 2019, për t'u rimbledhur pas përgjigjes nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë", - nënvizohet në njoftimin e pedagogëve të Shkencave Sociale.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
 SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pajisje kanclerarie, letër format A4 dhe bojë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,500,000 Lekë**."

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e paktyeshmë prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:


Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
 BIC: STANALTR  
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pajisje kanclerarie, letër format A4 dhe bojë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

Ofterta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 25 Shkurt 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

### Ministria e Arsimit: Bojkoti dhe ultimatumet nuk janë zgjidhje

Pas takimit me grupin e pedagogëve në ambientet e MASR, ministria e Arsimit, Besa Shahini ka dalë në një deklaratë për media. Shahini u shpreh se zgjidhja e problemeve të arsimit duhet të bëhet në universitetet dhe thëksoi se bojkoti nuk është zgjidhje. "Unë nuk besoj që bojkoti dhe ultimatumet janë mjete të nevojshme në këtë periudhë kur e gjithë vëmendja jonë është tek arsimi i lartë dhe kemi filluar një proces të mirëfillt të dialogut. Ishte një takim që shërbeu për të shuar një sërë keqkuptimesh që disa prej pedagogëve kishin për Paktin për Univer-



Ministria e Arsimit, Besa Shahini

sitetin. Ne do të vazhdojmë të dëgjojmë të gjithë, por do të vijojmë duke udhëhequr", - tha Shahini në fjalën e saj. Më tej kjo e fundit theksoi se pjesa më e madhe e pedagogëve dhe studentëve janë

pro paktit për universitetin. "Shumica e pedagogëve dhe studentëve janë mbështetës për paktin për universitetin. Janë pjesëmarrës në dialogun që kemi filluar dhe po na çojnë sugjerimet si ta përmirësojmë këtë dokument, që më pas do të jetë një kontratë mes qeverisë stafave akademikë dhe studentëve për të çuar përpara idetë më të mira për arsimin e lartë në Shqipëri. Gjatë këtyre takimeve po projektojmë edhe nevojat infrastruktururore në projekte konkrete që më pas do të rezultojnë në përmirësimin e infrastrukturës në Universitete", - shtoi ministria e Arsimit.

Kush do të testohet në pozicionin infermier, fizioterapist, mami e teknik laborator

Voltiza Duro

# Zbardhen emrat e 664 fituesve që aplikuan në 'Infermierë për Shqipërinë'

## Kalendari me datat e provimit në fazën e dytë

Të gjithë ata që kanë aplikuar për një vend pune në portalin "Infermierë për Shqipërinë", tashmë mund të njihen me pikët që kanë mundur të grumbullojnë. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot listat e fituesve për Qarkun e Tiranës si dhe datat e testimit të kandidatëve që kanë kaluar fazën e parë. Përkatesisht janë 357 fitues në këtë qark për Infermierinë; 81 fitues për pozicionin mami; 57 fitues në Teknik Imazherie; 80 fitues për pozicionin Teknik Laboratori; dhe 89 fitues në Fizioterapi. "Testimi do të bëhet në Godinën e Lëndëve Paraklinike (pas spitalit infektiv) Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, për të gjithë për të gjitha qarqet", thekson Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**DATAT DHE ORARI SIPAS QARQEVË DHE PROFILEVE:**

- Qarku Shkodër, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Tiranë, Qarku Durrës dhe Qarku Dibër profili Infermieri datë 9 shkurt 2019, ora 12.00.
- Qarku Elbasan, Qarku Korçë, Qarku Berat, Qarku Fier, Qarku Vlorë dhe Qarku Gjirokastrë profili Infermieri datë 10 shkurt 2019, ora 12.00.
- Qarku Shkodër, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Tiranë, Qarku Durrës dhe Qarku Dibër profilet Mami, Teknik laborator, Teknik imazherie, Fizioterapist datë 16 shkurt, ora 12.00.
- Qarku Elbasan, Qarku Korçë, Qarku Berat, Qarku Fier, Qarku Vlorë dhe Qarku Gjirokastrë profilet Mami, Teknik laborator, Teknik imazherie, Fizioterapist datë 17 shkurt, ora 12.00.

Qarku Tiranë Infermier				
Nr	Emer Atesi Mbiemer	Qarku	Profesioni	Piket nga dosja
1	Adelajda Varrosi	Tirane	infermier	7.8
2	Adolf Ilirjan Xhelo	Tirane	infermier	8.1
3	Adriana Dylber Beqo	Tirane	infermier	27
4	Aferdita Pema	Tirane	infermier	7
5	Aida Petrit Bodini	Tirane	infermier	9
6	Aida Eshref Aga	Tirane	infermier	7.5
7	Alba Agron Karaj	Tirane	infermier	8.9
8	Albana Nurcaj	Tirane	infermier	8
9	Albana Bekdash Dragoj	Tirane	infermier	18.5
10	Albana Esat Caca	Tirane	infermier	7.2
11	Albana Ferit Hasanaj	Tirane	infermier	9.2
12	Albana Hysni Zeneli	Tirane	infermier	10.4
13	Aleksander Ajet Terziu	Tirane	infermier	7
14	Alesja Selim Dallupi	Tirane	infermier	9
15	Alma gjon ndoj	Tirane	infermier	8.7
16	Alma Dhimitraq Toro Bitri	Tirane	infermier	24.3
17	Alma Ahmet Deda	Tirane	infermier	8.2
18	Altin Nazmi Hasbajrami	Tirane	infermier	8.4
19	Anduel Dyrmishi	Tirane	infermier	12.1
20	Anduela Pellumb Cako	Tirane	infermier	7
21	Ani Cifligu	Tirane	infermier	7.2
22	Anila Fadil Bodlli	Tirane	infermier	7.9
23	ANILA SALI LOKA	Tirane	infermier	7.3
24	Anisa Ilir Xhasula	Tirane	infermier	9.5
25	Anisa Nuri Bracja	Tirane	infermier	8.5
26	Anisa Uzeir Uzeiri	Tirane	infermier	7.3
27	Anita Cena	Tirane	infermier	9
28	Anjesa Behar Muja	Tirane	infermier	5.6
29	Antjana Bujar Dapi	Tirane	infermier	11.7
30	Anxhela Niko Mollaymeri	Tirane	infermier	7.3
31	Anxhela Emin Ruçi	Tirane	infermier	9
32	Arantes Zaim Sula	Tirane	infermier	5.1
33	Argjentina Gjinaj	Tirane	infermier	7
34	Arjentina Neim Qefa	Tirane	infermier	8
35	Arjola Mekrur Toci	Tirane	infermier	5.1
36	Arjola Vasil Islami	Tirane	infermier	18.6
37	ARMANDO RAMIS GORICA	Tirane	infermier	6.2
38	Arta Venetik Trashë	Tirane	infermier	15.3
39	Arta Bashkim Koka	Tirane	infermier	8.3
40	Artjola Agim Palushi	Tirane	infermier	8.9
41	Asjoneda Gezim Bracellari	Tirane	infermier	10.2
42	Aurora Meleq Qerimi	Tirane	infermier	6.5
43	Bardhok Pavlin Rajta	Tirane	infermier	6.4

44	Bendisa Kola	Tirane	infermier	8
45	Beram Mustaf Bici	Tirane	infermier	8
46	Besa Avdulla Seiti	Tirane	infermier	8.1
47	Bledar Shkelzen Dana	Tirane	infermier	6
48	Blerina Balla	Tirane	infermier	7.5
49	Blerina Prenga	Tirane	infermier	10.9
50	Blerina Hasan Rajta	Tirane	infermier	7.3
51	Blerita Vlash Laska	Tirane	infermier	16.7
52	Brunaldo Haxhi Limja	Tirane	infermier	6.7
53	brunilda asllan seferi	Tirane	infermier	7.3
54	Brunilda Izmir Abdija	Tirane	infermier	9.4
55	Brunilda Kadri Basha	Tirane	infermier	23.5
56	Bujar Bitri	Tirane	infermier	12
57	Cezar Qamil Hoxhaj	Tirane	infermier	6
58	Dajana Fatos Gjata	Tirane	infermier	8.8
59	Dallendyshe Shemsedin Muda	Tirane	infermier	6.7
60	Daniela Alit Papri	Tirane	infermier	7.3
61	Daniela Kristaq Hotova	Tirane	infermier	12.7
62	Delina Hader Alimadhi	Tirane	infermier	6.8
63	Denisa Kallaku	Tirane	infermier	14.5
64	Denisa Sula	Tirane	infermier	7.6
65	Denisa Topi	Tirane	infermier	10
66	Denisa Dem Gaxha	Tirane	infermier	8.2
67	Deshira Idriz Qoku	Tirane	infermier	25.4
68	Diana Selman Poda Vlashi	Tirane	infermier	9
69	DIANA SHTJEFEN NDOCI	Tirane	infermier	9.1
70	Dionisa Vlashi Petro	Tirane	infermier	7.3
71	Disareta Pali Shqau	Tirane	infermier	8
72	Djana Sadria	Tirane	infermier	8
73	Donatela Liman Ziri	Tirane	infermier	8
74	Donika Pinderi	Tirane	infermier	16.6
75	Donika Mersin Dogjani	Tirane	infermier	8.2
76	Dorentina Kadiu	Tirane	infermier	9
77	Dorina Karaj	Tirane	infermier	6.1
78	DORINA EDUART FASKO	Tirane	infermier	5.3
79	Dorisa Kilezi	Tirane	infermier	10
80	Drita Skender Struga	Tirane	infermier	8.3
81	Eda Myftari	Tirane	infermier	15.2
82	Edlira Sida	Tirane	infermier	8.3
83	Edlira Miraka	Tirane	infermier	15
84	Edona Skenderi	Tirane	infermier	11
85	Elda Pirra	Tirane	infermier	10
86	Elena Llazar Furxhiu	Tirane	infermier	5.4
87	ELENA NAMIK GOCE	Tirane	infermier	5.7
88	Elida Agim Alstafa	Tirane	infermier	6.5
89	Elida Nasi Bualli	Tirane	infermier	23.7
90	Eligerta Ali Damzi	Tirane	infermier	10.3
91	Eliona Ndue Mrishaj	Tirane	infermier	6.6
92	Elis Lavdosh Limaj	Tirane	infermier	10.7
93	Elizabeta Aleksander Medha	Tirane	infermier	7.1
94	Elizabeta Aleksander Medha	Tirane	infermier	7.1
95	Elona Hasa	Tirane	infermier	7
96	Elona Marra	Tirane	infermier	10
97	Elona Ramazan Balliu	Tirane	infermier	7.6
98	Elona Rasim Karrica (toci)	Tirane	infermier	12.9
99	emanuela rustem harremi	Tirane	infermier	7
100	Enea Pole	Tirane	infermier	7.1
101	Eneda Hajdar Muka	Tirane	infermier	9.7
102	Enkeleda Sabri Çullhaj (Myrta)	Tirane	infermier	23.4

103	Enxhi Sotir Petalli	Tirane	infermier	7.6	177	Lorena Guxim Hudhri ( Xhika )	Tirane	infermier	7.1
104	Erbliina Besnik Hoxha Laze	Tirane	infermier	8.6	178	Loreta Lek Dedaj	Tirane	infermier	6.4
105	ERID ARIAN CUKA	Tirane	infermier	7.4	179	Lubjana Nuraj	Tirane	infermier	15
106	Erilda Jonuz Troci	Tirane	infermier	9	180	Luljeta Sulejman Drazhi	Tirane	infermier	20
107	Erind Luan Hasa	Tirane	infermier	13.2	181	Lulzime Daut Selimaj	Tirane	infermier	7.9
108	Eriola Musa Tota	Tirane	infermier	8.1	182	Madona Mehmet Myhdini	Tirane	infermier	10.1
109	Eriselda Bejte	Tirane	infermier	8	183	Majlinda Hysen Neza	Tirane	infermier	7.9
110	Erjon mane sinani	Tirane	infermier	7.9	184	Majlinda Adem Alldërvishi	Tirane	infermier	6.5
111	Erlinda Shefki Halili	Tirane	infermier	9.9	185	Malvina Preng Legisi	Tirane	infermier	8
112	Ermal Haxhiasi	Tirane	infermier	11.3	186	Maniola Laver Arapi	Tirane	infermier	9
113	Ernest Perparim Xhemali	Tirane	infermier	6.4	187	Manjola Rama	Tirane	infermier	7
114	Ersilda Lutfi Çupi	Tirane	infermier	11	188	Manjola Arif Daja	Tirane	infermier	5.7
115	Ervin Fatmir Demollari	Tirane	infermier	5.1	189	Marigen Petrit Rama	Tirane	infermier	6
116	Ervisa Hiqmet Uta	Tirane	infermier	6.1	190	Marrije Zef Ndokaj	Tirane	infermier	25.9
117	Esjona Stefan Shimplaku	Tirane	infermier	6	191	marikela kastriot nure	Tirane	infermier	7.4
118	Esjona Stefan Shimplaku	Tirane	infermier	7.6	192	Marinela Karemanaj	Tirane	infermier	8.1
119	Etleva Cen Durici	Tirane	infermier	17.5	193	Marinela Astrit Braimllari	Tirane	infermier	8.9
120	Fatjon Bajram Kokonozi	Tirane	infermier	6.2	194	Marjana Ramadan Kastrioti	Tirane	infermier	7
121	Fatjona Mina Vogli	Tirane	infermier	9	195	Marjon Jonus Sino	Tirane	infermier	12.3
122	Fatlum Mbrati	Tirane	infermier	6.4	196	Marsida Xhavit Lulla	Tirane	infermier	7.8
123	Fatlum Mbrati	Tirane	infermier	6.4	197	Matilda Edmont Gremi	Tirane	infermier	8.1
124	Festime Ndreu	Tirane	infermier	14.6	198	Matilda Kastriot Arshi	Tirane	infermier	23.1
125	Fiorela Gordi	Tirane	infermier	9.4	199	Megi Haki Hima	Tirane	infermier	9.6
126	Fjoreda Ismen Selimaj (Cengu)	Tirane	infermier	5.9	200	Melisa Bashkim Goci	Tirane	infermier	6.5
127	Florida Petrit Luku	Tirane	infermier	8.9	201	Mereme Bogdani	Tirane	infermier	7
128	Freskida Genci Petro	Tirane	infermier	7.8	202	Merita Hamit Hima	Tirane	infermier	6.1
129	Ganian Shpetim Hyseni	Tirane	infermier	5	203	Merita Ramazan Sadiku	Tirane	infermier	6.9
130	Ganimete Osmanaj Asllani	Tirane	infermier	8	204	Miranda Pavlin Sinanaj	Tirane	infermier	11
131	Gentiana Pemaj	Tirane	infermier	9	205	Mirel Vogli	Tirane	infermier	6.4
132	Gentiana Adem Dedja	Tirane	infermier	14	206	MIRJANA KRISTAQ QOSE	Tirane	infermier	5.9
133	Gentiana Xhevit Mici	Tirane	infermier	7	207	Mustafa Visha	Tirane	infermier	6
134	gentjana mark leka	Tirane	infermier	11.2	208	Mynire Qazim Domi	Tirane	infermier	8.2
135	Gjergji Hizmo	Tirane	infermier	8	209	Myrvete Murat Gjuta	Tirane	infermier	8.3
136	Griselda Fadil Xhika	Tirane	infermier	6.5	210	Naile Lutfi Allushi	Tirane	infermier	27.7
137	Hajrije Ilir Hamiti	Tirane	infermier	7.2	211	Nazife Meleq Kodheli	Tirane	infermier	8.4
138	Hamide Llacja	Tirane	infermier	9.3	212	Nardela Shkelqim Sadiku	Tirane	infermier	11.2
139	Hanko Kamxhiu	Tirane	infermier	8	213	Neritan Feriz Imeraj	Tirane	infermier	8.9
140	Have Lika	Tirane	infermier	9	214	Nertila Enver Resulaj	Tirane	infermier	14.5
141	Ida Arben Myrtaj	Tirane	infermier	9.7	215	Nertila Myslym Hoxhalli	Tirane	infermier	6.2
142	Ilda Budlla	Tirane	infermier	10	216	nevila nazmi xhafa	Tirane	infermier	5.1
143	Ilda Cekrezi	Tirane	infermier	8	217	Oligerta Bardhi	Tirane	infermier	6.2
144	Ilirjana Doga	Tirane	infermier	7	218	Oltion Uran Saraçi	Tirane	infermier	7.1
145	Ina Gjoka	Tirane	infermier	8	219	Orjola Edmon Mucllari	Tirane	infermier	8
146	Ina Asllan Troksi	Tirane	infermier	6.9	220	Orkida Bici	Tirane	infermier	8
147	Ina Selajdin Kishta	Tirane	infermier	7.2	221	Ornela Refik Murati	Tirane	infermier	8.1
148	Ina Vebi Lazri	Tirane	infermier	6.4	222	Ortenca Murati	Tirane	infermier	9
149	Irena Hyka	Tirane	infermier	7.1	223	Ortenca Bujar Lika	Tirane	infermier	8
150	Irena Roci	Tirane	infermier	9	224	Pranvera Medin Kryemadhi	Tirane	infermier	10.9
151	Irena Hysen Laçi	Tirane	infermier	20	225	Qamil Astrit Allushi	Tirane	infermier	11.2
152	Irida Likdisha	Tirane	infermier	8	226	Qerim Prendi	Tirane	infermier	10
153	Irimi Ngjuro	Tirane	infermier	9	227	Ramadan Fecorr Tabaku	Tirane	infermier	6
154	Irma Hysen Grëmi	Tirane	infermier	8.5	228	Redion Medi Halilaj	Tirane	infermier	7.7
155	Irma Nevruz Korca	Tirane	infermier	24.9	229	Reols Reci	Tirane	infermier	5.8
156	Irma Mexhit Husha	Tirane	infermier	6.6	230	Rexhina Hasani	Tirane	infermier	9
157	Irsa Ardian Kozici - Sulo	Tirane	infermier	9.8	231	Rinita Xhafer Dervishaj	Tirane	infermier	6.4
158	Jetmira Margarit Gjinaj	Tirane	infermier	7.4	232	Roland Isuf Pançi	Tirane	infermier	5
159	Jonida Astrit Bani	Tirane	infermier	6.1	233	Roland Reshit Alla	Tirane	infermier	7
160	Jonida Lefter Pasha	Tirane	infermier	7.3	234	Romina Kolimja	Tirane	infermier	8.7
161	Jonida Lutfi Hamiti	Tirane	infermier	7	235	Romina Dritan Ulupo	Tirane	infermier	9.1
162	Jonila Drizaj (Shani)	Tirane	infermier	6.1	236	Ronilda Nexhmi (Xhemollari) Peti	Tirane	infermier	7
163	Jurgena Rufat Pjetri	Tirane	infermier	8.6	237	Rovena Nazif Torameni	Tirane	infermier	9.7
164	Jurgesa Syrja Sadikaj	Tirane	infermier	6.1	238	Rozina Troksi	Tirane	infermier	12.7
165	Kastriot Hidri	Tirane	infermier	9	239	RUDINA ENVER HOXHA	Tirane	infermier	8.3
166	Kelsi Jovan Kerxhalli	Tirane	infermier	6.2	240	Selma Gëzim Zefaj	Tirane	infermier	8
167	Kevin Halil Zoto	Tirane	infermier	5.1	241	Selviqe Ahmet Sinani	Tirane	infermier	20.2
168	Klauzeta Yzedin Dollani	Tirane	infermier	11.8	242	Shqipe Hasbegu	Tirane	infermier	8
169	Klea Tace	Tirane	infermier	8.7	243	Shqipe Gzim Leka	Tirane	infermier	6
170	Kristiana Marku	Tirane	infermier	9	244	Shqipe Osman Bozhiqui ( Sinani )	Tirane	infermier	7.6
171	Lavdie Gjoci	Tirane	infermier	19.5	245	Shyqyri Bajram Kurti	Tirane	infermier	16.6
172	Lediana Lulo	Tirane	infermier	7	246	Sidorela Grrica (Dauti)	Tirane	infermier	7
173	Ledina Hysen Kodra	Tirane	infermier	8.3	247	Sidorela Pal Kolaj	Tirane	infermier	9.4
174	Leontina Marku	Tirane	infermier	8	248	SILVI BUJAR LUFO	Tirane	infermier	7.2
175	livia adem dalipi	Tirane	infermier	9.4	249	Silvja Sulejman Thanasaj	Tirane	infermier	9
176	Llukan Koti	Tirane	infermier	20.8	250	Sonila Bardhyl Cenaj	Tirane	infermier	6.6
					251	sonjela bashkim neziri	Tirane	infermier	7.5

(vijon)

## MONODRAMA



# STEFAN ÇAPALIKU:

## "DOME", heroi i kohës sonë, nga censura politike në atë ekonomike

Fatmira Nikolli

Monodrama e interpretuar nga aktori shkodran në Teatrin Eksperimental këtë fundjavë

"Enver Hyseni ka shitur gjithçka përveç shpirtit e nderit"

A mund të mblidhet e gjithë jeta në një valixhe? Jeta, mund të jetë edhe më pak se kaq. Mund të jetë edhe më e vogël. Në pothuaj një orë, aktori i teatrit "Migjeni" Enver Hyseni rrëfen veten e tij në skenë. Ka vetëm një valixhe përpara. Në të janë mblodhur gjithë kujtimet. Rolet që ka luajtur dhe ato që i mbeten peng, teksa rrinë në hije pa bërtitur veten, pa thënë "jam". Për Stefan Çapaliku, që ka shkruar pjesën "Dome" bazuar mbi jetën e Enver Hysenit, ai është një hero i kohës sonë. Ai ulet në karrige, me një cigare në dorë, e një filxhan kafeje përpara, rrëfëhet te qoshku i preferuar, duke marrë me vete në fund, fotot e roleve, kujtimet me babën, skenarin e shumëpëritur dhe pengun se bëri pak.

"Dome" është një monodramë e shkruar enkas për aktorin e Teatrit "Migjeni" të Shkodrës, Enver Hyseni. Shkrimi i saj është produkt i një vëmendje të zgjuar gjatë bisedave të gjata mes autorit dhe aktorit ndër procese pune apo ndenje të rastësishme. Ajo që i ka bërë përshlyetje autorit gjatë këtyre bisedave ka qenë gjithmonë sinqeriteti i thellë me të cilin Enver Hyseni tregon te aspekte të ndryshme të jetës së vet, që rrinë të lidhura ngushtë me epokën, së cilës i përkasin. E ka bërë për vete, gjithashtu, edhe thjeshtësia e tregimit e veçanërisht mungesa e mllëvefe dhe inateve. Si çdo person tjetër edhe Enver Hyseni e ka jetuar kohën e vet herë ndër margjinat e herë në kryeradhë; e ka jetuar brenda trazgimit dhe komikës, e ka jetuar në varfëri dhe në lavdi, vetëm dhe me shokë, me mish e me shpirt. Pra, autori ka dashur



Stefan Çapaliku

të shkruajë e më vonë të ndërtojë një sfaqje të thjeshtë, "sfaqje aktori", një sfaqje që të ngjashë si një akt rrëfimi, pse jo edhe kërkimi ndjesë, pardonit, si një gjest që kaq shumë i mungon shoqërisë sonë.

Enver Hyseni lindi në Shkodër më 1 gusht 1951. Mori mësimet aktorin në Institutin e Lartë të Arteve për një periudhë të shkurtër (1973-1974) dhe i ndërpreu studimet për arsye ekonomike. Më 1975 nisi punën në Teatrin "Migjeni" të Shkodrës, ku edhe doli në pension në vitin 2016. Në këtë periudhë detyzëvçare luajti më se gjashtëdhjetë role në teatër e katër në filma. Punoi me regjisorë si Serafin Fanko dhe u shqua për role karakteri. Zëri tipik dhe plastika e brendshme e

bëjnë një aktor krejtësisht të veçantë dhe interesant.

Në një intervistë për "GAZETA SHQIPTARE", Stefan Çapaliku ndalet te Hyseni dhe aktori shqiptar në dy kohë, te koha e presionit dhe presioni ekonomik, te arti i diktuar dhe arti që nuk është, te peneli që mungon. Monodrama e interpretuar nga aktori shkodran në Teatrin Eksperimental këtë fundjavë në orën 19:00.

- A qenë bisedat me Enver Hysenin që të bënë të nisje shkrimin e monodramës apo doje ta shkruaje dhe nise bisedat?

Ka ndodhë pikërisht kështu, siç e ndërtoni ju pyetjen. E shkruara ka qenë rezultat. Në fakt, është një marrëdhënie e fshehtë

dhe jo shumë e përshkruar që shkruantari ka me kujtesën e vet. Sepse ka qenë ajo çfarë mua më ka ngelur në mendje pas një periudhe mjaft të gjatë ndenjesh me mikun tim, aktorin Enver Hyseni.

- Përmes jetës së tij jepet edhe raporti i artistit me shtetin a pushtetin në dy kohë: kontrolli i pareshtur para '90-ës dhe mosvëmendja e pa skaj pas '90-ës. Si kanë ardhur këto dy skaje?

Si duket në vendin tonë marrëdhëniet e artistit me pushtetin janë marrëdhënie armiqësore. Artisti që del nga epoka e komunizmit për të hyrë në sistemin e ri politik nuk bën asgjë tjetër përveçse del nga censura politike për t'u dorëzuar pa kushte censurës ekonomike. Është njësoj si të krahasojnë kushtet kur shteti komunist të jepte penelat dhe bojërat dhe të imponojë sesi duhej të pikturoje, me kushtet e sotme kur shteti të thotë: pikturoj si të duash, ndjehi i lirë. Por nuk të jep as penela e as bojëra.

- Kishte çaste që monologët, rrëfimet e Hysenit më sollën ndërmend "Me Syrin e një klouni". Vuajtja e një artisti është njësoj kudo apo jo?

E dua shumë atë vepër që ju po citoni, por mendoj se Domja im e kryen rrëfimin nëpërmjet së vërtetës së tij dhe jo të vërtetës së autorit. Në këtë kuptim është njësoj si të krahasojmë fikcionin me dokumentaren.

- Do doja të ndaleshim te monologu "i kalit". A ka secili frerët e tij prej ku e tërheqin?

Ai monolog i Migjenit dhe disa citime të tjera nga Viktor Hygo apo ndonjë tjetër e fusin tekstin tim në rrjedhat e estetikës postmoderne. Unë kam zgjedhë ato

copa letrare, të cilat Enver Hyseni i ka pasë gjithnjë ëndërr që t'i interpretojë. Pra, është njësoj si të rrmosh në ndën ndërgjegjen apo sirtaret e fshehta të dëshirave të maskuara.

- Pata ndjesinë në fund se jeta jonë është e gjitha në një valixhe - e gjithë jeta është vetëm aq, një valixhe, një emër mbi të dhe shumë kujtime...

Jeta mundet me qenë edhe diçka më e vogël se ajo valixhe. Madje ka njerëz që nisen për të shkruar në atë jetë me duar ndër xhepa. Por Enver Hyseni e përballon burrnisht fundin e karrierës së vet. Ai është një figurë deheroizuese e që e merr të gjithën si lojë. Si një lojë shpesh e luajtur pa rregulla e pa arbitër.

- A është te Hyseni "tragjedia" e gjithë brezit të tij? Jeta e aktorëve që një kohë ju desh të bëheshin "shitës ambulantë" ose ju desh të shisnin shpirtin për të mbijetuar?

Enver Hyseni ose Domje im ka shitur gjithçka përveç shpirtit e nderit. Ai e ka kuptuar më thjesht se shumëkush tjetër se të gjithë ne jemi aktorë e se madje aktorët që nuk luajnë në teatër janë ku e ku më të zotë se ata që marrin rrogën për të interpretuar. Dome është një hero i kohës sonë.

- Një akt rrëfimi, një meza culpa. Sa i keni lejuar vetes të 'dilni' nga jeta e Hysenit për të futur në të jetë të tjera, copëza jetësh që kaluan pa i vënë re?

Sigurisht që në atë rrëfim jam edhe unë. Unë kam kryer një akt postproduksioni duke i montuar copat e jetës së Domes në një ritëm dramaturgjik, që ndjek disa rregulla si suspansat, kulminacionet, shpërthimet agresive, humorin e pazat vepruese.



# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 646

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 2 Shkurt 2019

## RIKE ROÇI

### BEN ENDRREN REALITET

Nisin provat në teatër, së shpejti në një rol si aktore



Prej një viti në akademinë e arteve në Itali, ish-banorja realizon aspiratat e saj

## ÇIFTI

Lidhje, fejesë e tani dasmë?  
Fatma dhe Alfio po na  
habisin me planet e tyre



RREFEN

## ERION ZEQRARJ:



Pika ime e dobët, e  
çfarë dua te një femër

"Dashurië e vjetra nuk harrohen, vetëm largohen nga prioritetet e tua"

## ALESIA BAMI

E HOQËN ME NJË SMS NGA PUNA, REAGON MODELJA  
S'ËSHTE E DREJTË, POR NUK DO TË NGRE PADI



## Pushoi 'lufta', Fifi 'bën paqe' me reperen e njohur

Pak muaj më parë, Fifi bëri bujë me këngën 'Habibi', e cila qartazi u konsiderua diss për reperet e reja nga Tayna tek Rina. Por një pjesë e tekstit i dedikohet haptazi Melindës. "Deri dje Lulija ke me dimija, sot me brekë të hiqta", thoshte Fifi duke iu referuar këngës "Lulija". Megjithatë, mes vajzave tashmë duket se raportet janë për t'iu pasur lakmi. Ka qenë vetë Fifi ajo që në 'InstaStory' e ka shpërndarë me link këngën e re të Melindës duke vulosur në këtë formë zbutjen e raporteve. Megjithatë, duket se Fifi vazhdon të ngelet 'në luftë' për dy emra të tjerë, Tayna dhe Rinën.



## Dashuria nuk ka moshë! Ja diferenca mes Dua Lipës dhe të dashurit të saj

Asnjë nuk e dinte se Dua Lipa dhe Isaac Carew kanë një diferencë të madhe në moshë. Këngëtarja shqiptare dhe Isaac Carew kanë një histori të bukur dhe paksa të komplikuar dashurie. Ata janë takuar dhe janë lidhur para se Dua të gjejë famën, ndërsa më pas edhe janë ndarë për një vit, ndarje për të cilën Dua ka bërë shumë këngë, ndër ta edhe 'New Rules'. Isaac është një model nga Britania e, gjithashtu, një shef kuzhine, e ndërsa në pamje duket mjaft i ri, moshë ka diferencë të madhe me atë të Duas. Carew është 32-vjeçar, ndërsa Dua është 23-vjeçe dhe mes tyre ka një diferencë prej 9 vjetësh. Megjithatë, dashuria nuk njih moshë dhe mund të themi që shkojnë shumë bashkë!

## Del "Romeo dhe Zhuljeta", Mozzik e Loredana zbulojnë përmes këngës se si nisi historia e tyre e dashurisë

Ata janë një ndër çiftet më të komentuar në mediat rozë. Ata bënë bujë të madhe me lidhjen e tyre pasi asnjëri nuk e pranonte. Ndërkohë që para një muaji u bënë prindër për herë të parë, por shumë pak dihet se si ata u lidhën. Vetë reperi Mozzik dhe partnerja e tij, Loredana Zefi, kanë menduar të na e tregojnë këtë me anë të këngës së tyre të fundit "Romeo & Juliet", në rreshtat e së cilës përshkruajnë si u njohën dhe si lindi gjithçka mes tyre. "T'kom drogë, t'kom venë, Me ty u nis gjithçka ni folloë n'Instagram.. T'shkrujta, t'shkrujta dhe... s'e lujta. Erdha n'dhomë tone edhe vujta. Për ty jam veç ni gjarpër, ta marroj... Me ty e ndaj ditën, me ty e ndaj natën. Me ty e ndaj kadën, bukën, pjatën", janë fjalët e Mozzik për partneren, duke treguar se si shumica e çifteve të sotëm, edhe ata janë njohur në 'Instagram'.




## Qenka martuar e asnjë s'e dinte?! Suada Sherifi rrëfen të vërtetën

Ajo është një ndër bukurshet e showbiz më të komentuar kohët e fundit për shkak të përfshirjes së bashkëshortit me policinë. Ndërkaq, e ftuar në emisionin "Thumb", Suada Sherifi ka zbuluar më shumë nga jeta e saj private. Ish-missi gjatë intervistës me moderatorët ka folur hapur për jetën e saj profesionale dhe të rejtat nga jeta personale. Në promon e emisionit të publikuar së fundmi Suada ka habitur me deklaratën e saj ku ka pranuar se në të vërtetë ajo është martuar, dhe këtë e ka bërë në fshehtësi të plotë. "Kenë ndërmend të bëni një dasmë të madhe?" - e pyesin moderatorët Suadën. "Në fakt, në fakt, unë e kam mbajtur pak të fshehtë po unë jam martuar, goca"- përgjigjet Suada, e cila është edhe nënë e një vajze 2-vjeçare Deizi. Më e fshehtë se kaq? Edhe pse kuriozë jemi të shohim a ka veshur vellon e bardhë bukurshja apo jo?

## Do martohet së shpejti? Në kërkim të të dashurit të Rashel Kolanecit

Ajo është një nga vajzat më sexy dhe më të komentuar të rrjetet sociale. Ndërkaq së fundmi ka habitur me deklaratën e saj që me siguri nuk e prisnit. Rashel Kolaneci ka treguar se do të martohet së shpejti. Në një postim në rrjetet sociale ajo ka treguar se në familjen e saj të gjithë janë martuar në moshën 20-vjeçare. Ndërkohë bukuroshja tregon se asaj do i marrë dhe pak kohë që të vendosë për jetën e saj. Të jetë shaka apo edhe atë do ta 'zë fati' i familjarëve të saj?



## “A do ta doje burrin po të ishte i varfër?” Angela Marini na habit me përgjigjen e saj

Padyshim që bukuroshja Angela Marini është një nga femrat më sexy shqiptare që prej vitesh njihet edhe ndërkombëtarisht. Përveç dhuratës së që i ka falur natyra për të qenë një super femër, ajo pati fat edhe në jetë ku u martua me një bashkëshort pasanik. Për këtë fakt Angela është komentuar shpesh. Ndërkohë një nga fansat e ka pyetur se nëse do e donte bashkëshortin e saj po të ishte i varfër. Ajo është përgjigjur: ‘Jo. Me siguri do e doja më shumë’. Kjo tregon edhe për të mbyllur gojët e liga për faktin se lidhja e tyre mbahet vetëm në sajë të pasurisë së rumunit.

## Të holla e të bukura si modele? Aurela Hoxha rrëfen sekretin e një trupi fantastik

Ajo është një ndër femrat më të lakuara dhe tërheqëse të mediave Arozë. Aurela Hoxha, me linjat e saj perfekte dhe stilin e veçantë ka ditur gjithmonë të jetë në super formë. Për të arritur këto rezultate me siguri Aurelës i është dashur të heqë dorë nga disa ushqime. Këtë e ka treguar nëpërmjet një përgjigjeje në ‘Instastory’. Teksa një fansë e ka pyetur për regjimin e saj ushqimor, bukuroshja shqiptare i ka zbuluar pikat kyçe ku bazon dietën e saj. “Sport dhe ushqim i kontrolluar”, shkruan modelja. Më herët ajo ka treguar se është kthyer në vegane dhe me siguri kjo mënyrë të ushqyeri i ka ndikuar për mirë. Aurela ka shtuar se moskonsumimi i mishit e ka ndihmuar të humbasë kile.



## Eni Koçi publikon videon e turpshme të Gretës dhe Gencit, reagon keq këngëtarit

Jo më larg se pardje, u përhap me shpejtësi lajmi se Greta Koçi dhe Genci Prelvukaj i kanë prishur marrëdhëniet e mira që kishin me njëri-tjetrin. Shkak u bë një postim i këngëtares në ‘Instastory’ ku e pyetur nga një fans, ajo përgjigje se momentalisht marrëdhëniet e saj me Gencin janë në krizë. Mirëpo kjo duket se ka qenë thjesht shaka nga Greta pasi këngëtarja ka një marrëdhënie shumë të mirë me kunatin. Këtë e vërteton video e fundit e Enit, e cila shfaqet duke u ankuar për faktin se Greta dhe Genci e kanë lënë vetëm dhe qëndrojnë në celularë. Madje në një moment Greta dhe Genci shfaqen duke folur në gjuhë kineze dhe Eni tallet me këtë fakt. Sapo e sheh që Eni po i filmon, Genci duket se turpërohet. Ai nxehet, lëshon celularin nga dora dhe i thotë Enit ta mbyllë videon. Kaq shpejt telashe në parajsë?

Rrëfihet ish-banori i "Big Brother": Së shpejti me një emision ku do ketë brenda aventurën dhe zbulimin

Rikthehet

Pamela Aliaj

**E**dhe pas shkëputjes nga një prej reality-show-t më të njohur në vend, ai vendosi që të kishte si pjesë të pandarë të tijën ekranin. U bë i njohur nëpërmjet "Big Brother 3" por kjo ishte vetëm fillimi për të. Edhe pse sportist, aktualisht me ekipin e volejbollit të Tiranës, ai na prezantohet edhe si spiker në një nga mediat shqiptare. E kemi parë në moderimin e shumë eventeve të njohura, por tashmë në këtë intervistë do të vijë ndryshe. Erion Zeqiraj rrëfihet për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" për planet e tij pasi i është rikthyer ekranit pas një periudhe 2-vjeçare. Nuk do të mjaftojë vetëm spikerimi për të, sepse ai është duke përgatitur edhe një tjetër emision, i cili është krejt ndryshe nga të tjerët nga ku është prezantuar. Një emision më afër me njerëzit dhe më i prekshëm me përditshmërinë do të vijë shumë shpejt dhe Erioni së bashku me stafin e tij do të na sjellin padyshim emocione. Por nuk mbetet me kaq: Në intervistë Erioni na rrëfen rrugën se si të mund të shpëtojim nga një zemër e thyer. Këto e shumë të tjera në rrëfimin e mëposhtëm.

**Pas pjesëmarrjes në një reality-show vendosët të jeni gjithmonë e më shpesh pjesë e medias. Si erdhni propozimi për tek Tema Tv?**


Televizioni është një nga pasionet e mia dhe si diçka që e ke pasion nuk është e lehtë të largohesh. Mendova t'i rikthehesha dhënies së lajmeve pas 10 vitesh, sepse është diçka që më ka pëlqyer gjithmonë, informimi dhe zhvillimet, ngjarjet e ndryshme në vend e në botë. Mendoj se ky ishte momenti i duhur dhe oferta që s'mund ta refuzoja. Pas një pauze prej dy vitesh nga televizioni për të rifreskuar imazhin, m'u bë oferta nga TV Tema. E pranova për t'u shfaqur pak ndryshe nga sa njerëzit më kujtojnë nëpërmjet emisioneve apo programeve të ndryshme televizive që unë kam marrë pjesë.

**A keni pasur propozime të tjera si spikerimi apo tjetër? A i keni pranuar? Nëse jo, pse?**

# ERION ZEQRIRAJ:

## Pika ime e dobët e çfarë dua te një femër

*"Dashuritë e vjetra nuk harrohen, vetëm largohen nga prioritetet e tua"*



Propozime kam patur, por mendova të largohesha pak nga emisionet e përditshme edhe për të ndryshuar rutinën. Por kjo nuk do të thotë që në një të ardhme nuk do të kem një emision timin ndryshe nga ato që kam moderuar deri më tani.

Në një intervistë të mëparshme keni thënë se ishit duke u përgatitur për një emision tuajin për të cilin

**keni kohë që po e mendoni ta realizoni. Kur keni në plan për ta vënë në jetë?**

Çdo gjë në kohën e duhur e në momentin e duhur. Duke qenë se jam i angazhuar shumë edhe në punë apo sport, koha është e kufizuar për të bërë këtë program. Sapo të krijohen kushtet do të jem me emisionin tim.

**Për çfarë bëhet fjalë konkretisht?**



Janë disa ide që janë hedhur në letër në formën e një projekti dhe sapo kushtet të krijohen do merret vesh përse bëhet fjalë. Do ketë brenda aventurën dhe zbulimin. Gjithashtu, edhe personazhet me intervista ndryshe, nuk do mungojnë. Dua të bëj pjesë të emisionit njerëz që jo çdo ditë mund t'i takojmë apo e dimë se pikërisht ata i bëjnë këto gjëra që ne i prekim përditë. Pra, njerëz të thjeshtë, por që në vetvete janë personazhe të punëve që bëjnë.

**Ju keni qenë dhe pjesë e "Miss Universe Albania & Kosovo". Si ishte një eksperiencë e tillë? A do të keni të tjera të tilla në plan të shpejti?**

Prej shumë vitesh jam pjesë e stafit që merremi me organizimin e "Miss Universe Albania" dhe vitin që shkoi në "Miss universe Kosovo".

**Cila do të ishte partnerja juaj ideale në moderim nëse do të mund të zgjidhnit në një event si Miss Albania?**

Sapo kemi filluar përgatitjet për organizimin e "Miss Universe Albania", një spektakël që do të realizohet në qershor ku vajza fituese do përfaqësojë Shqipërinë në një prej konkurseve më të mëdha të bukurisë në botë, "Miss Universe", ku konkurrojnë 98 shtete.

**Ku e ndjen veten më mirë Erioni: në volejboll apo në media?**

Sporti është një pasion që është kthyer edhe në profesion dhe stil jetese. Kam 19 vite që merrem me volejboll si lojtar i ekipit të Tiranës. Të dyja janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra, por jam i lumtur dhe ndihem me fat që



kam patur mundësinë edhe e kam t'i bëj të dyja, si sportin edhe televizionin.

**A është dikush në jetën tuaj tani?**

Në jetën time janë shumë njerëz. Familja dhe shoqëria, asgjë më shumë për momentin.

**Cila është mënyra më e mirë sipas jush të harroni një dashuri të vjetër?**

Të mos biesh në dashuri është mënyra më e mirë, në të kundërt vështirë se njerëzit që vijnë në jetën tonë harrohen. Thjesht mund t'i largojmë nga prioritetet tona, por jo të harrohen.

**Nëse do të mund të ktheheshit pas, çfarë do**

**donit të ndryshonit në vendimet që keni marrë për jetën tuaj?**

Asgjë nuk do ndryshoja. Besoj çdo gjë që ndodh, ndodh për një arsye. Unë e kam shijuar në maksimum deri tani jetën dhe nuk jam pishman për asgjë kështu që mund ta vlerësoj të shkuarën dhe vendimet e marra me notën maksimale.

**Cilat janë elementet e karakterit të një femre që vlerësoni më tepër?**

Sinqeriteti, ëmbësia dhe shpirti luftarak për gjërat që i përkasin. Një femër që është e fortë për veten e saj dhe jo e varur nga të tjerët.

**Çfarë i jepni përparësi në jetën tuaj që ju ka ndihmuar të ecni përpara?**

Besoj se me punë dhe fat arrihet çdo gjë. 20 % fat e 80 % punë.

**Cila është pika juaj e dobët?**

Nuk di të them jo. Kjo besoj është pika më e dobët duke qenë se njerëzit e marrin për dobësi. Dhe kur në një moment ju thua "jo", ju duket sikur ju ke bërë padrejtësi. Me pak fjalë, i miri të tjerëve i keqi vetes (Qesh). Por unë ndjehem mirë kur të tjerët ndjehen mirë pasi unë i kam ndihmuar.

**Çfarë i frikësoheni më tepër në jetë?**

Humbjes e njerëzve që dua.



## Rrëfëhet këngëtari i njohur: I lidhur me Marsela Çibukaj, muzika ime është dedikim për të

E dhe pse të gjithë mundohen që jetën private ta ruajnë me fanatizëm, herët a vonë e vërteta del në shesh. Kjo ka ndodhur edhe me këngëtarin e muzikës 'rock', Vitmar Basha, i cili ka qenë i ftuar në emisionin 'Lart e Poshtë', me gazetarin Eraldo Rexho. Gjatë programit ai foli për koncertin e tij të mbajtur ditën e djeshme tek 'Teatri i kukullave', ku prezantoi albumin e tij të titulluar '9'. Ndër të tjera Basha pranoi për herë të parë se është në një lidhje me këngëtares e njohur Marsela Çibukaj dhe se motivi i tij për këtë album është pikërisht ajo. Ai theksoi se Çibukaj ka qenë shtysa kryesore e gjithçkaje dhe e ka quajtur këngëtares muzë të tij. Vitmar shtoi, gjithashtu, se albumi i nxjerrë së fundmi është një dedikim për Marselën, duke qenë se muzika është ajo çfarë e ka bashkuar dyshen. Pra, pasioni bashkoi dy artistët!




## Ne vuajmë të ftohtin, Gena me bashkëshorten shijojnë parajsën në ishull

Ndërkohë që të gjithë mezi po presim që të lëmë pas ditët e ftohta, këngëtari i njohur Gena ka preferuar të largohet së bashku me bashkëshorten për të shijuar rrezet e diellit. Momentalisht këngëtari po shijon disa pushime ekzotike në Tailandë. Gena dhe e shoqja duket se janë arratisur në vendin e duhur për t'i shpëtuar monotonisë dhe të zakonshmes. Dyshja gjendet në ishullin interesant Phuket! Dielli, det e shumë dashuri, na ka bërë që ta kemi akoma e më tepër zili këngëtarin!

## Lidhje, fejesë e tani dasmë? Fatma dhe Alfio po na habisin me planet e tyre

Fatmirësisht për dy vite ata nuk arritën 'të kapeshin' nga mediat rozë për lidhjen e tyre kështu që e shijuan në fshehtësi të plotë. Ndërkohë që pas bërjes publike të historisë së tyre të dashurisë, duket se Fatma dhe Alfio kanë vendosur të jenë të hapur për çdo gjë rreth romancës së tyre. Postojnë foto së bashku, flasin hapur rreth dashurisë që kanë për njëri-tjetrin, e madje duket se çifti paska filluar të mendojë edhe për hapin e madh në marrëdhënien e tyre. Dasma! Po, po Alfio dhe Fatma e kanë konsumuar edhe këtë temë e duket se viti 2020 do t'i gjejë ata si burrë dhe grua. Të paktën këtë na lënë të kuptojmë shefi i kuzhinës i ftuar në emisionin "Thumb", i pyetur rreth dasmës ai tha se ka mundësi që vitin e ardhshëm çifti të martohet. Një tjetër dasmë në horizont dhe mezi presim t'i shohim të dy duke qenë se janë kthyer në një nga çiftet më të dashur të ekranit!



## Pas ndarjes nisin ngacmimet? Seldi ironizoi Mimosën për këngën e re



Ndarja nga Seldi Qalliu nuk e ndali këngëtares e njohur të nxirrte në treg këngët e saj vitin që lamë pas. Ndërkaq Mimoza Shkodra po përgatitet për një tjetër projekt. Dhe siç është njoftuar kjo këngë do të jetë një bashkëpunim me kompozitorin, Irkenc Hyka. Mimoza dhe Irkenci bënë të ditur se tashmë kanë nisur xhirimet për klipin e ri. Por nga ana tjetër, Seldi duket se e ka ironizuar këtë projekt mes tyre dhe këtë e lidhë me një postimi në Insta Story. "Fiona & Shreku, vijnë së shpejti", -shkroi Seldi të shoqëruar me një emoji duke qeshur, ndërsa vendosi që ta fshinte postimin pak orë më vonë. Ta ketë këtë reagim për këngën e re të Mimosës?

Prej një viti në akademinë e arteve në Itali, ish-banorja realizon aspiratat e saj

# Rike Roçi bën ëndrrën realitet, së shpejti me një rol si aktore

*Nisin provat në teatër, bukuroshja nga Durrësi nën rolin kryesor*

Në një rrëfim të bërë disa javë më parë për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", ish-banorja e "Big Brother" 3, Rike Roçi ka thënë se kishte nisur studimet pasi ishte përzgjedhur në një nga akademitë më prestigjioze në Itali lidhur me aktrimin. Ndërkohë që e pyetur më parë nëse do të niste diku nën rolin e një aktoreje, ajo e ka mohuar. Ndërkaq, jo më larg se dje, bukuroshja nga Durrësi ka postuar një video në 'Instastory' ku shfaqeshin dy sekuenca të shkëputura në teatër ku në kuadër shihej Rike. Burime për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" thonë se ish-banorja e "Big Brother" ka nisur provat si aktore në një rol të rëndësishëm. Edhe vetë Rike nuk ka



dashur të prononcohet më tej kur është pyetur lidhur me videon, por me shumë gjasa do ta shohim të jetë pjesë e një roli të rëndësishëm në teatër. Mesa duket ish-banorja ka arritur që me forcat e saj të realizojë atë që prej kohësh e kishte ëndërr të saj dhe


mesa duket tashmë është bërë realitet. Në postimet e mëparshme dhe deklaratat e dhëna dukej se Rike e kishte parësore të realizonte një pasion të tillë dhe akademia në të cilin ajo edhe fitoi para një muaji audicionet si një ndër më të mirat, ka bërë punën e saj. Nuk

mbetet veçse t'i themi Rikes sa më shumë suksese në rrugën e ndërmarrë dhe që mezi presim ta shohim tek-sa aktron nën rolin e fituar!

Dha intervistë në një media tjetër, balerinën e pushojnë nga pozicioni i velinës në Klan

## E hoqën me një sms nga puna, reagon Alesia Bami: S'është e drejtë, por nuk do të ngre padi

Prej dy ditësh është duke bërë bujë lajmi lidhur me largimin nga puna të ish-velinës së "Stop", Alesia Bami. Në media u përhap lajmi, sepse bëri çudi që balerina nuk ishte prezente në puntatën e radhës dhe vendin e saj si pa problem e kishte zënë një vajzë tjetër. Më tej, nëpërmjet një mesazhi në 'Instagram', bukuroshja ka shpjeguar se e kishin hequr nga puna vetëm nëpërmjet një mesazhi dhe ditën e nesërme dikush tjetër kishte zënë vendin e saj. Ajo shpjegon, gjithashtu, se arsyeja ishte sepse kishte dhënë një intervistë në "Ftesë në pesë" të Bieta Sulos tek Top Chanel, duke mos marrë leje nga vendi i punës. Ndërkaq e kontaktuar nga "Bluetooth" i "Gazeta Shqiptare", modelja nuk ka dashur të japë reagime të tjera lidhur me heqjen nga puna veçse pyetjes lidhur nëse do të ngrejë padi kundër punëdhënësve, ajo i është përgjigjur që nuk do të ngre padi ndërkohë që për më tepër do të prononcohet në një deklaratë live. Të shohim çdo të vendosë Alesia, ndërkohë që më parë ka thënë se do ta shohim shumë shpejt në një tjetër program.



Dje në "Deutsche Welle"

# Ballkani "vlon", pas Ramës Bolton telefonon Thaçin

NGA BEKIM SHEHU

(vijon nga faqja 1)

... një zë, në mënyrë që t'i hapet rrugë dialogut Kosovë-Serbi. Pas deklarimit se ambasadorit të SHBA-ve, i cili kërkon që t'i hapet rrugë dialogut, janë dy zyrtarë të lartë të administratës së SHBA-ve, John Bolton, këshilltar për Siguri Kombëtare i Presidentit Donald Trump dhe Wess Mitchell, Ndihmësekretar amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, që zhvilluan biseda telefonike me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Kjo u bë e ditur nga vetë Presidenti i Kosovës, i cili në dy postime të ndara shkroi:

"Me Këshilltarin për Siguri Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, ambasadorin John Bolton, biseduam për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe për partneritetin e përhershëm në mes të Kosovës dhe SHBA-ve. Ambasadorin Bolton e sigurova se Republika e Kosovës mbetet e përgjegjshme për vazhdimin e dialogut dhe do të flasë me një zë, ashtu siç ka kërkuar Presidenti Trump. Ne jemi të bindur se dialogu do të fillojë së shpejti dhe do të përfundojë me një marrëveshje gjithëpërfshirëse, që siguron njohjen reciproke dhe anëtarësimin në NATO, BE dhe OKB", shkroi Presidenti Thaçi, duke siguruar se, "Kosova ka ecur gjithmonë përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe miqësia do të jetë e përhershme".

Një tjetër bisedë telefonike, Presidenti i Kosovës bëri të ditur se e ka zhvilluar edhe me Ndihmësekretarin amerikan të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Wess Mitchell, me të cilin siç thotë ka biseduar "për situatën politike në Kosovë".

"Ne u pajtuam që ta vazhdojmë përkushtimin tonë në fazën e fundit të dialogut ndërmjet Kosovës



dhe Serbisë. Të gjitha institucionet në SHBA janë në mbështetje të Republikës së Kosovës për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, e cila përfundimisht do të sjellë paqe dhe stabilitet afatgjatë në Ballkanin Perëndimor. Kosova është unike dhe plotësisht e vetëdijshme për këtë mundësi historike", shkroi Presidenti i Kosovës.

Një ditë më parë, Thaçi takoi në zyrën e tij, ambasadorit amerikan në Kosovë, Philip S. Kosnett, kryeparlamentarin Kadri Veseli, kryeministrin Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministrat Fatmir Limaj e Behgjet Pacolli. Në këto takime, siç tha Presidenti, "kanë biseduar për çështje të rëndësishme shtetërore, për ruajtjen e partneritetit të përgjeshëm me SHBA-të dhe për procesin e dialogut Kosovë-Serbi".

"Interesi shtetëror duhet të bëjë bashkë gjithë spektrin politik, për

të marrë vendime të rëndësishme për perspektivën e qytetarëve dhe për të ardhmen tonë euroatlantike, në përputhje me interesat e SHBA-ve dhe partnerëve strategjikë të Kosovës. Prandaj, në ditët në vijim, pres vendimmarrje të përgjegjshme në përputhje të plotë me interesat shtetërore", tha presidenti.

Mirëpo, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të SHBA-ve që qeveria e Kosovës e kryesuar nga Ramush Haradinaj ta pezullojë taksën ndaj produkteve të Serbisë dhe t'i hapet rruga dialogut, kryeministri Haradinaj nuk e ka ndër mend të lëkundet nga qëndrimi i tij.

Haradinaj tha sot me (01.02) se "taksa është vendosur kundër Rusisë duke u rreshtuar në krahun e SHBA-ve".

"Taksa nuk hiqet deri në njohje të Kosovës nga Serbia, mbajeni mend këtë. Pse duhet të ekzistojë

taksa deri në njohje. Nuk është lehtë për mua ta ha mallin e dikujt që m'i ka vra anëtarët e familjes, e as për juve që keni të vrarë apo të zhdukur anëtarë. Në dialog kërkoj që të jepet tokë, si Republikën e Dodikut në Bosnjë, ajo atëherë është Rusi brenda nesh", tha Ramush Haradinaj në një akademi përkujtimore.

Sipas tij, "Serbia është munduar ta zhbëjë Kosovën, e ka djegur, e ka shkatërruar, ndërsa sot nuk e jep asnjë cent për këtë tokë", shtoi Haradinaj duke ngritur pyetjen se pse duhet ndërlikuar taksa ndaj produkteve të Serbisë me dialogun ndërmjet dy vendeve për një marrëveshje finale gjithëpërfshirëse.

Njohësi i çështjeve rajonale, Naim Rashiti, nga Instituti për Zhvillimin e Politikave Ballkanike, thotë se klasa politike kosovare duhet të flasë me një zë dhe hapur për opionet e vendeve të zhvilluara.

"Dialogu me Serbinë duhet të trajtohet si proces politik, i cili mund të ketë epilog, por më shumë gjasë edhe mund të mos ketë. Liderët duhet të flasin hapur për opionet dhe qëndrimet e vendeve kryesore dhe bisedojnë me vete se çka duan nga ky proces. Kryeministri Haradinaj duhet të suspendojë taksën, sepse ka arritur qëllimin, që Amerika të jetë e involvuar dhe tani me SHBA-të janë më të involvuara se kurrë", shkroi Naim Rashiti.

Presioni i SHBA-ve që Kosova ta heqë taksën ndaj produkteve të Serbisë dhe t'i hapë rrugë dialogut dhe qëndrimet e ndara të udhëheqësve politik kosovarë lidhur me këtë çështje, ka lëkundur koalicionin qeveritar ndërmjet PDK-së së Kadri Veselit dhe AAK-së së Ramush Haradinaj.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli propozoi që taksa të hiqet për 120 ditë në mënyrë që të reflektojë edhe Serbia nga ana e saj. Mirëpo me këtë nuk po pajtohet partneri i koalicionit Ramush Haradinaj. Ka dy ditë që partnerët e koalicionit po zhvillojnë takime të pandërprera, ndërsa nuk dihet nëse qeveria "Haradinaj" mund t'i rezistojë presionit ndërkombëtar për ta hequr taksën ndaj Serbisë. Autoritetet në Beograd nuk pranojnë ta rinisin dialogun me Prishtinën pa hequr taksën ndaj produkteve të tyre. Ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić i bëri thirrje bashkësisht ndërkombëtare që të bëjë presion mbi Prishtinën që të hiqet taksa.

"Apeljmë te BE t'i bindin disa aktorë politikë në rajonin e Ballkanit Perëndimor se veprimet e njëanshme nuk janë zgjidhje e problemit, por se është më me rëndësi t'i kthehemi dialogut me Prishtinën, si rrugë e vetme e drejtë, e cila duhet të sjellë deri të zgjidhja gjithëpërfshirëse", citojnë sot mediet në Serbi, Ivica Dačićin.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Opinion *i* Ditës

# Kur debati politik merr fytyrën e Gjushit

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... e rëndë të akuzave për vjedhjen e votave me ndihmën e trafikantëve të drogës po edhe me atë, se këto "scoop-e", tani po i zbulohen nga "Zëri i Amerikës". Për ta fashitur ai ishte i gatshëm të bënte gjithçka. Të luante karagozin duke u fotografuar me llaçin jash-të, të vinte në dukje thuthuqërinë e Palokës, të vetëviktimizehej me plagët që kundërshtarët politikë kanë shkaktuar në dekada mbi familjen e tij dhe se fundi, të hidhte bombën tymuese, plot aludime, se Sali Berishës i është refuzuar viza amerikane.

Me të dëgjuar këtë akuzë, Sali Berisha reagoi me po të njëjtën mënyrë. Në vend që të përgjigjej me një pohim apo mohim të thjeshtë (gjë që e bëri vetëm pasi mori konfirmimin se ambasada e rrugës së Elbasanit nuk e komentonte këtë fakt) ai u lëshua çmendurisht në vizatimin e portretit të pasardhësit të tij, si një njeri që i rrëmben gratë shokëve, që ka mohuar djalin e vet, që ka akuzuar të atin për incest.

Në fakt, të gjitha këto i ka përsëritur me qindra herë që prej vitit 2000 e këtej. Por ato i duheshin këtë të enjte vetëm për dominuar aludimet për një penalizim nga Uashingtoni.

Po t'i shikoje, dje, me vëmendje, ata ngjanin me dy gladiatorë që ndonëse përlësheshin, donin të ndihmonin njëri-tjetrin nga i njëjti hall, fshehja e së vërtetës. Rama kërkonte me çdo kusht që debati për vjedhjen e votave me anë të trafikantëve të drogës të zinte sa më pak hapësirë. Berisha rrekej të fliste për çdo gjë tjetër, goftë edhe për shturjen e familjes së Ramës, por jo të jepte një prononcim të prerë për çështjen e vizës.

Më e bukura, kulmi i kulmeve, ishte se në këtë skemë u përfshi edhe Gjushi, që ishte personazhi kryesor i kapur nga përgjimet. Asgjë nuk qe e rastësishme. PS, që prej kohësh nuk i nxjerr figurat e saj pa leje në TV, që i pengon ata të ballafaqohen për tema që i kanë në disavantazh, i kishte dhënë leje kryebashkiakut të Durrësit. Natyr-



isht me një mision të qartë. Që Dako të luante rolin e budallait.

Dhe po aq i rëndomtë sa fjalori i tij që nuk i kalon 200 fjalët, po aq vulgar sa kollarja që kish lidhur pas qafës, po aq banal sa vetë e keqja, Vangjushi i realizoi të gjitha pritsshmëritë. Ai relativizoi gjithçka duke e shitur si vlerë prezencën në tavolinat e kriminelëve, e quajti si detyrë elektorale shoqërinë me ta dhe pohoi se nuk kërkon t'u kontrollojë miqve certifikatën e pënalitetit.

Përballë kësaj idiotësie të ve-shur me tipare njerëzore ishte i kotë çdo lloj debati moral.

Dhe duhet pranuar që në fund të ditës prezenca mbizotëroi mbi esencën. Pyetjet themelore: pse është arkivuar nga prokuroria dosja 339/1; pse kudo në përgjime dalin banditë që vjedhin vota; pse stafetën e denoncimeve e ka marrë "Zëri i Amerikës"; a ka probleme Berisha në Uashington; a janë ato të lidhura me qëndrimin e tij të ash-për kundër ndryshimit të kufijve, u

sfumuan krejtësisht nga spektakli i radhës.

Po të shikoje gjatë ditës së djeshme mediat online dhe gjatë mbërmjes emisionet politike, bindeshe edhe më tepër për këtë. Aty mbizotëronte pesha e show-t. Aty rëndësën kryesore e fitoi politika që pranon të marrë fytyrën e Gjushit, vetëm që të fshehtë atë të vërtetën.

Prandaj me keqardhje duhet pranuar se si Rama, si Berisha, si Dako arritën edhe njëherë të na e hedhin.

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje rekomandohet që të kalojnë të shtunën larg shtëpisë. Mendoni se çfarë aktivitetesh mund të realizoni për të pasur një ditë sa më të këndshme. Sa i përket anës romantike, duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë njeriut të zemrës.

### DEMI

Disa Demë do të bëjnë një udhëtim të shkurtër. Ka gjasa që do t'ju duhet t'i përgjigjeni një pyetje provokuese. Megjithatë mendohuni mirë dhe përgjigjuni me qetësi për të shmangur ndonjë konflikt të mëtejshëm.

### BINJAKET

Binjakët do të kalojnë një ditë mjaft argëtuese. Ndoshta kjo do të ndodhë për shkak të pranisë së miqve tuaj të ngushtë. Mund të takoni dikë, i cili do t'ju ngjallë mjaft interes. Ka gjasa që dikush t'ju largojë vëmendjen nga një çështje kryesore.

### GAFORJA

Gaforet do të kenë mjaftueshëm kohë sot për t'u përkushtuar shtëpisë. Madje mund të kryeni edhe disa blerje të rëndësishme për ndryshimin e arredimit të shtëpisë. Mund të nisni një lidhje të romantike, e cila do t'ju bëjë të ndiheni mjaft mirë.

### LUANI

Përpiguni të shmangni mendimet negative, pasi nuk do të mund të zgjidhni problemet gjatë ditës. Bëni mirë të relaksoheni dhe të argëtoheni. Rekomandohet që të udhëtoni ose të jeni të pranishëm nëpër aktivitete që ju cilrojnë nga stresi.

### VIRGJERESHA

Nuk do të ndiheni shumë energjikë gjatë kësaj dite. Kjo do të ndikojë negativisht në planin që kishit bërë për ditën e sotme. Mund të keni dëshirë të qëndroni vetëm në qetësi dhe të mos përfshihen në aktivitete të tjera.

### PESHORJA

Peshoret do të kalojnë një ditë të këndshme sot. Edhe ana financiare parashikohet të jetë mjaft e mirë. Sa i përket aspektit personal, gjithçka do të shkojë ashtu sikurse e kishit parashikuar. Përpiguni të shmangni personat, tek të cilët keni vënë re shenja xhelozie.

### AKREPI

Dita e sotme nuk do të jetë ashtu sikurse e dëshironi. Mund të përballeni me mosmarrëveshje në familje, me miqtë ose me fqinjët. Rekomandohet të shkoni diku për t'u qetësuar si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht.

### SHIGJETARI

Bëi kujdes me shëndetin. Rekomandohet që më shumë të zgjidhni veshje të ngrohta sesa veshje me stili. Ndërsa sa i përket aspekteve të tjera, gjithçka do të shkojë mirë. Sot mund të bëni miq të rinj.

### BRICJAPI

Bricjapët duhet të mendojnë më pak dhe të veprjnë më shumë. E rëndësishme është që të veproni në momentin e duhur. Tregohuni të vëmendshëm ndaj të afërmeve tuaj. Dëgjoni këshillat e tyre dhe vlerësojini ato. Do të keni sukses në dashuri.

### UJORI

Ujorët nuk duhet t'i ndajnë njerëzit në të mirë dhe në të keq. Mund të bëni disa blerje të rëndësishme personale. Në mbërmje duhet të qëndroni afër familjarëve tuaj. Disa prej tyre do të kenë nevojë për mbështetje tuaj.

### PESHQIT

Sot do të ndiheni të mbushur plot optimizëm, gjë të cilën do t'ia përcillni edhe të tjerëve. Megjithatë rekomandohet që të bëni kujdes me sjelljen ndaj të tjerëve. Zgjidhni fjalët dhe mos bëni shaka me persona që nuk e pranojnë.

KOLUMBIANI



Bomberi që po mahnit Italinë

Zapata: Juves i shënoj me dëshirë, sepse kam luajtur me Napolin

Kampionati italian këtë vit është "pushtuar" nga Atalanta dhe nga gjërat e jashtëzakonshme që ajo po bën ndeshjet e fundit. Por, nëse kjo skuadër mund të thoshim që ka një lider,

atëherë ky do të ishte Duvan Zapata, i cili deri më tani ka shënuar 15 gola në kampionat. Duke folur për "Sky Sport", kolumbiani ka sqaruar formën e mirë që po kalon dhe "vesin" që ka dhe

i shënon shpesh Juventusit. "Ne jemi shumë të kënaqur dhe kemi një ekip shumë të fortë. Unë isha në dijeni të përpjekjeve financiare të bëra nga klubi për mua, por gjithsesi isha shumë i qetë.

Nëse Gasperini ka një sekret duhet ta pyesësh vetë, unë di që ai përgatit ndeshje të mëdha dhe na transmeton shumë energji. Dita-ditës ne kuptojmë që mund të mundim këdo dhe rezultatet që nuk po gjenim në fillim po vijnë një e nga një. Unë Juves i shënoj, sepse kam luajtur me Napolin (qesh). Unë jam i lumtur dhe shpresoj të shënoj në çdo garë", kanë qenë fjalët e sulmuesit kolumbian.

Teuta ngjitet e dyta në kuotën e 35 pikëve, sa Kukësi, Tirana shkon në 21 pikë, i shkëputet zonës së ftohtë

Jeton Selimi

Në "Selman Stërmasi" u luajt ndeshja Tirana-Teuta e vlefshme për javën e 20-të të Kategorisë Superiore. Teuta kaloi e para në avantazh në "Selman Stërmasi". Ishte minuta e dytë e ndeshjes dhe Erllis Frashëri ka dhënë krosim perfekt në zonën e rreptësisë, aty ku Gerhard Progni ka djegur mbrojtjen bardheblu duke shënuar një gol mjaft të bukur. Tirana nuk do ta vonojë shumë përgjigjen. Kombinimet mjaft të bukura të Halilit dhe Ngo kanë nxjerrë anglezin në pozicion ideal shërimi dhe shtatllarti nuk ka falur. Tirana rikthen baraspeshën në minutën e 38-të dhe shënon me të parën guajtje në kuadrat në këtë takim. Në pjesën e dytë Teuta ka qenë pranë dyfishimit në minutën 63-të, por topi ka dalë jashtë. Traore në të 70'-ën lëshoi një të majtë potente në hyrje të zonës pas një inkursioni të bukur, por topi del shumë larg shyllës së majtë të Abibit. Gjithsesi, pjesa e dytë nuk do të ketë ritmin e së parës dhe pas përfundimit të minutës së 5-të shtesë, gjyqtari Hamiti do të mbyllë takimin. Skuadrat do të ndahen nga një pikë, e cila më shumë i bën punë Tiranës sesa Teutës. Bardheblutë ngjiten në kuotën e 21 pikëve, 6 më shumë se Kamza e vendit të parafundit. Ndërsa bregdetarët do të arrijnë Kukësin e vendit të dytë në kuotën e 35 pikëve, por verilindorët do ta luajnë nesër sfidën e tyre ndaj Flamurtarit.

**ARAPI**  
Renato Arapi luajti takimin e parë në Superligë pas thuasje tri vitesh, ndërsa për mikrofonin e "Supersport", rrefen përshtypjet e tij. "Ishte emocionues dhe ishte i vështirë. U bëra 1 muaj i gjysmë që nuk po aktivizohej. As në miqësoret nuk u aktivizua për shkak të problemeve. E nisëm mirë, shënuam shpejt, e pësua prapë shpejt. Pjesa e parë ishte e luftuar dhe e barabartë. Pjesa e dytë më shumë foli për ne. Patëm 2 raste me Prognin. Edhe barazimin mund ta quaj një rezultat pozitiv. Kemi

# Progni e hap, Ngo e mbyll. Tirana e Teuta ndahen në paqe

Në "Selman Stërmasi", Tirana-Teuta përfundon 1-1



SUPERLIGA	
Java e 20-të	
Të premtën	
Tirana - Teuta	1-1
Të shtunën	
Kastrioti-Skënderbeu	14:00
Flamurtari - Kukësi	17:00
Të dielën	
Laçi - Luftëtari	14:00
Kamza - Partizani	14:00

SULMUESI BARDHEBLU

Ngo: Tirana është po aq e fortë sa edhe Partizani  
Majkëll Ngo po shënon rregullisht tashmë dhe golat e tij po kthehen në pikë të çmuara për Tiranën. Sulmuesi anglez shprehet për "Supersport" se bardheblutë nuk kanë asnjë diferencë nga Partizani kryesues apo Kukësi, ndërsa "përkëdhel" dhe trajnerin Mema. Po kthehesh njeriu vendimtar i Tiranës... Jam i kënaqur të ndihmoj skuadrën, të marrim pikë dhe objektivi ynë është të kapim ekipet para nesh. Nuk e shoh veten si lojtar kryesor, kemi 11 lojtarë në fushë. Edhe në ndeshjet që nuk shënoj, do mundohem të jap asist. Patët probleme me Memën në fillim, tani gjithçka është sheshuar. Çfarë ka ndryshuar tani?  
I dini problemet në pjesën e parë të sezonit, nuk luajta shumë. Ishin kryesisht probleme psikologjike. Tani me trajnerin, ai ka bërë një punë të shkëlqyer, pasi na ka ndryshuar mentalitetin. Unë kisha disa çështje me të, sepse edhe nuk e njihja, por tani e shoh si një person tjetër, nuk është mirë të gjykojsh një njeri para kohe. Tani, edhe puna ime që kam bërë, është falë tij.

Më mirë egoist apo altruist?  
Unë nuk e shoh veten si egoist, për sa kohë ekipi fiton dhe marrim pikët, nuk më intereson. Pse lëvizni dhe harxhoni energji duke u kthyer nga sulmi poshtë në mesfushë?  
Sot nuk po luam me një numër 10 në fushë. Hasani mungonte. Me të kemi një partneritet dhe nuk kishim lojtarin që bën nisen e ekipit. Kur nuk e prek topin shumë, ose pres në sulm, unë mërzitem dhe dua të marr në këmbë. Jam i mirë dhe e luaj, e dua të ndihmoj ekipin me pasime.  
Çfarë do donit t'ndryshonit Tiranës në këto momente? Pse keni një dëshirë të bëni konflikte në fushë me njerëzit?  
Nuk dua të bëj konflikte me askënd, por është një reagim i imi, nga pasioni për lojën. Mbrojtësit duan të më prekin dhe më godasin edhe pa top, e bëjnë shpesh dhe kjo më bezdis. Tani kemi më shumë komunikim dhe unitet në fushë dhe ia dalim të arrijmë më shumë. Më bezdisin dhe është reagim normal. Unë dua të kap ekipet më iart, dua të konkurroj me Partizanin, Skënderbeun e Kukësin se mendoj se jemi të mirë sa duhet për të konkurruar me ta.

mundësi dhe aftësi për të bërë më tepër. Terreni ishte shumë i rëndë. Është e vështirë me një ekip që mblidhet mbrapa. Nga ndeshja në ndeshje ekipi do përmirësohet, cilësitë i ka brenda. Skënderbeu ka pasur

shumë kualitete kur kam qenë në pjesë. Kishin lojtarë që bënin diferencën. Niveli i kampionatit ka rënë disi, por është bërë më i bukur, sepse është shumë i luftuar. U bë kohë që nuk kam luajtur me 3. Që në ko-

hën kur kam luajtur te Skënderbeu. Përshtatja nuk ishte e vështirë, duhet të jemi sinkron. Deri diku shkoji mirë, kemi akoma mundësi të përmirësohemi nëse trajneri vendos të vazhdojmë me 3 mbrojtës".




Situatë aspak e mirë tek Interi

Hija e Kontes qëndron mbi Spaletin, drejtuesit e thërrasin në mbledhje

Dëborra që ka rënë në Milano, vetëm sa e bëri më të thellë zhytjen e Interit. Jashtë luftës për titull, jashtë Champions League që në pengesën e parë, jashtë Kupës së Italisë në prag të derbit me Milanin. Pra, ka mbetur vetëm që të mbyllet kampionati minimalisht në vendin e katërt dhe të synohet një figurë e mirë në Ligën e Europës për të shpëtuar çfarë ka mbetur për t'u shpëtuar, ta paktën sa u takon rezultateve. Problemi është se në këtë moment, brenda dhomave të zhveshjeve zikaltër ka shumë probleme. Dhe zgjidhjet nuk janë të lehta, duke nisur që nga kontrata e Mauro Ikarit, rinovimi i të cilit duket se nuk është në diskutim, por që ka prishur jo pak gjumin e tifozëve, pasi kjo çështje ka ndikuar dhe në rendimentin e argjentinasiit, që po ka vështirësi të shënojë në aksion. Të mos flasin për rebelët Perisic dhe Naingolan, të dy të vendosur për ta lënë Milanon sa më shpejt, por që janë mbajtur në skuadër kundër dëshirës. Ajo që e ndjen peshën, është skuadra. Sikur të mos mjaftonin rebelët, edhe lojtarët e Lautaro Martinezit nuk po bindin (me babain e këtij të fundit që kishte ngritur zërin më herët, që i biri nuk gjen hapësirë e duhura) dhe po vazhdon të shpërdorojë mundësitë që po i jep Luçiano Spaleti. Vetë Spaleti ka përfunduar në syrin e ciklonit interist, me tifozët që e shikojnë si të mbaruar qëndrimin e tij në Milano. Pas eliminimit nga Kupa e Italisë, trajneri toskan ka pasur një takim kokë më kokë me drejtuesit. Asnjë ultimatum, por një mbledhje rreth momentit të vështirë të Interit, i paafte të marrë rezultatet që të gjithë kanë pritur. Dhe nëse kësaj i shtojmë zërat e ardhjes së mundshme të Kontes.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Emri i Monet.
8. Një top në rrjetë.
11. Carl Edward, që shkroi Contact.
12. Qe bukuroshi që u hidhte ferë perëndive.
15. Qe era hynore e japonezeve.
16. Një pjesë e lartësive.
18. Muzikanti që... nuk përsëriste.
20. Lumë në Rusi.
21. Eshhtë i lartë ai i kampionit.
22. Kalifi që themeloi Kairon.
24. Kështu e quajti Krishti shën Pjetrin.
25. Janë në guvë.
26. Iiloni portier.
27. Markë makine.
28. Ashtu si duhet të përgjigjet fituesi.
29. Inicialet e Mann.
30. Një parabolë e tenist.
31. Fillojne tatepjeten.
32. Ente Autonome.

33. Jean, që solli duhanin në Europë.
  34. Mund të jetë dëshmor.
  36. Pak stabilitet.
  37. Arturo i Brecht.
  39. Një pjesë e onkologjisë.
  40. Mbyllin një shtëpi.
  41. Të parat në stafetë.
  42. Qe profet i vogël.
  45. Me break në tenis.
  46. Mbyllin një sirtar.
  47. Qe perëndesha që lindi Arionin.
- VERETIKAL**
1. Inicialet e Santana-s, kitarist.
  2. Nota e diapazonit.
  3. Eshhtë frika nga shehet e hapura.
  4. Diftong në duar.
  5. Duhën në ekstreme.
  6. Qe libri erotik i Mallanaga Yatsyayana-s.
  7. Lauda ish-pilot i Formula 1.
  8. Janë lotët që gjithkush i derdh me kënaqësi.
  9. Një poemë.
  10. Fund tuneli.
  12. Një elegancë si Aramis.
  13. Qe kryeqyteti i Asirisë.
  14. Qe toreanor i famshëm.
  15. Urdhëroi sakrifikimin e Ifigjenias.
  16. Eshhtë pushteti i... bashkisë.
  17. Qe lumi i Karontit.
  18. Inicialet e Klee piktor.
  19. Ishte gjuha e Jezu Krishtit.
  23. U shndërrua në dre nga Afërtdita.
  28. Rex i Nero Wolfe.
  35. Nino, kompozitor i njohur.
  36. Një... story e John Le Carré.
  41. Kufizojnë një sektor.
  42. Inicialet e Einstein.
  43. Inicialet e Matthieu, këngëtare.
  44. Kufizojnë sportet.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Lindi Isakun.
3. Në krye të bashkisë.
5. Në djep kur nuk... je.
7. Nota e diapazonit.
9. Emri i parë i Erasmit të Rotterdami.
12. Mbyllin akte.
14. Filozofi i famshëm me historinë e gomarit.
15. Diku në qendër.
16. Rrallë është përgjysmë.
17. Bëri edhe Madame Butterfly.
18. Norman, psikopati të Psycho.
19. Të parat në sjellje.
20. Vret me një re.
21. Gjarpri që u vra nga Apolloni.
24. Lindi Perseun.
26. Besniku mesfushor
27. Ai i vajtimit është në Jerusalem.
29. Carol, aktore.
30. Në krye të subjekteve.

**VERTIKAL**


1. Ishte sundimtari i provincave perseisha.
2. Inicialet e Duvall
3. Qytei i njembinjëdritarve.
4. Ishin armiqtë babilonasve.
5. Shkroi Jacuqes le fataliste.
6. Eshhtë edhe tendencë.
7. Joan i interpretuar nga Celentano.
8. Jetojnë në vetmi.
9. U soll në Europë në Jean Nicot.
10. Ai i Aida-s është Radames.
11. Një ishte edhe Deceballi.
13. Inicialet e Rohmer regjisor.
18. Titulli i Bruce Springsteen.
20. Hidhet një me... kërcim.
22. U shkrua nga Camus.
23. Fillojnë takimin.
25. Fillojnë natën.
27. Pierce teniste.
28. Grisur pa gur.
31. Fillojnë panikun.
32. Shijuar pa shuar.
34. Fleming, që krijoi James Bond.
35. Kështu merr ai që... mbaron.
36. Mbajtësja e topit në golf.
37. Ekstreme për gotik.
38. Carson i fumnetit-t.
40. Një padi kur s'është ai.
41. Bëhen arianë me një anë.
42. Harris që krijoi Hannibal Lecter (inic).
43. Bëhet nuse me ne.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		4		5	8		7	3
2		7						8
		6	2		7	5		
4	1			8	3			
	3		1		6		5	
			7	9			2	1
		5	3		1	4		
6						9		2
8	7		9	4		1		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	2	4	5	9	6	1	3	8
6	3	5	7	1	8	2	9	4
8	1	9	4	2	3	7	6	5
3	7	2	1	4	9	8	5	6
9	6	1	8	5	2	3	4	7
4	5	8	3	6	7	9	1	2
1	8	6	9	7	4	5	2	3
2	9	7	6	3	5	4	8	1
5	4	3	2	8	1	6	7	9

*Argëtim filozofik*

-Sa më larg të shikoni prapa, aq më larg përpara ka gjasa që të shihni.

-Jam gati të takoj Krijuesin tim. A është i përgatitur Krijuesi im për provën e rëndë të takimit me mua, kjo është një çështje tjetër.

E vërteta është e padiskutueshme, e keqja mund ta sulmojë atë, injoranca mund ta përqeshë atë, por në fund, ja ku është.

Një pesimist e shikon vështirësinë në çdo mundësi; një optimist e shikon mundësinë në çdo vështirësi.

Të përmirësosh do të thotë të

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	K	A	12	3	E		2	1	6	3	10	2
1	9	1	8			11	1	12	2	3	7	
3	2	2		13	5	11	1	2	4	2	4	
3	2		13	3	7	3	2	4	5	3		
15		5	9	8	4	2	3	2	3	2		
9	3	5	4	11	3	2					12	
7	4	5	10	3	2		2	1	11	1		
4		9		15	16			17	2	4	6	
5	1		17	20	4	10	15			17	6	
3	9		11	1	2	3	10	2	1	2		
10	1		19	3				18	7	1	2	
1	19	8	4			11	4	7	1	2	4	

A	Z	O	V	E	T	N	A	B	A	
Z	A	G	A	R	R	A	M	B	A	S
I	C	K	A	L	I	N	I	O	B	I
L	C	A	S	U	S	B	E	L	L	I
T	E	N	T	A	T	I	V	A	T	V
M	A	R	T	I	N	A	E	N	K	E
E	T	E	S	E	N	R	O	M	A	N
T	I	M	E	T	I	P	I	A	F	E
A	M	O	R	F	R	A	T	A	R	
L	O	N	Z	E	T	A	F	A	Z	A
E	R	I	C	C	E	V	O	N	E	
T	E	A	M	A	L	B	A	N	E	T

**PËRÇJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

S	E	V	E	N	U	P	S	T	E	F	F	I
A	M	I	N	K	A	P	I	T	A	L	I	
R	I	T	E	T	R	E	L	F	E	L	A	M
A	L	E	T	E	F	I	L	O	K	F	E	T
H	E	K	A	M	I	K	A	Z	E	K		
P	R	O	T	O	K	O	L	L	A	R	E	
K	A	T	A	M	A	R	A	N	I	O	T	
I	R	C	O	L	I	N	R	O	M	Y		
T	E	M	A	E	I	B	O	R	I	S		
A	N	I	T	A	A	M	I	L	A	N	O	
R	A	N	V	I	T	M	J	E	R	A	N	
E	T	I	L	E	N	F	R	A	T	I		
B	A	O	B	A	B	P	E	D	A	N	A	T
R	P	E	R	I	P	A	T	E	T	I	K	E
A	P	E	L	R	I	V	R	N	A	R		
V	E	L	P	I	R	A	M	I	D	A	M	
A	R	K	O	L	O	R	I	T	I	L	E	
P	R	O	T	A	G	O	N	I	S	T	E	T
K	A	N	T	A	I	A	T	K	A	T	E	
A	R	I	E	L	T	A	T	E	R	T		
S	A	L	A	T	I	K	T	S				
P	R	A	E	S	I	P	I	R	A	T	I	
I	R	R	M	I	B	A	N	O	R	E	T	
K	R	A	T	E	R	E	T	G	J	I	R	I

*Thënie të mençura*

- ndryshosh; të jesh i përsosur do të thotë të ndryshosh shpesh.
- Politika është aftësia për të parashikuar atë që do të ndodhë nesër, javën tjetër, muajin tjetër dhe vitin tjetër. Dhe të kesh aftësinë që më pas të shpjegosh pse nuk ndodhi.

- Socializmi është filozofia e dëshimitit, kredo e injorancës dhe ungjillit i zllisë.
- Një shaka është diçka shumë serioze.
- Një i burgosur lufte është dikush që përpiqet t'ju vrasë dhe dështon, dhe më pas ju kërkon juve që mos ta vrisni.

